



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.03.2016, ora 17.00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i draft opinionit final të Komisionit të Venecias të datës 26 shkurt 2016 dhe mënyra e reflektimit të rekomandimeve të draft opinionit final të Komisionit të Venecias të datës 26 shkurt 2016 në tekstin e rishikuar të projekt amendamenteve kushtetuese të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Spartak Braho, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Z.Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Znj.Aurela Anastasi – Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Kristaq Traja – Koordinator i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Z.Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Gent Ibrahimimi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Meqenëse kuorumi është, ne mund të procedojmë normalisht.

Qëllimi i kësaj mbledhjeje është për të diskutuar rreth mënyrës sesi do të trajtojmë vazhdimin e mëtejshëm të procesit për përmbylljen e projektit kushtetues në reflektim edhe të draftraportit final paraprak për momentin, por shumë shpejt përfundimtar, të Komisionit të Venecias. Është një fakt i njohur që kemi një projekt konkret, mbi të cilin ka pasur dy opinione zyrtare të Komisionit të Venecias, opinioni i ndërmjetëm, mbi rekomandimet e të cilit u rishikua drafti kushtetues, u bënë ndryshimet dhe reflektimet e nevojshme, iu përcoll Komisionit të Venecias së bashku me opinionet e grupeve politike parlamentare. Komisioni i Venecias mbi projektin e rishikuar ka sjellë draftin paraprak të vlerësimit të tij rreth këtij projekti, është një dokument paraprak, sepse që të konsiderohet një dokument final duhet të mblidhet seanca plenare e Komisionit të Venecias, e cila zhvillohet në datat 11 dhe 12 mars, pra këtë javë në Venecia. Gjithsesi, drafti paraprak është më se i nevojshëm, është më se i mundshëm për të përcaktuar qëndrimin që do të mbahet dhe reflektimet që do të duhet të bëhen në projektin kushtetues të rishikuar.

Vlerësimet e dhëna nga Komisioni i Venecias janë të shprehura qartazi, ndaj besoj dhe shpresoj fort që të gjithë në këtë tavolinë dhe jashtë kësaj tavoline, që janë të interesuar rreth këtij projekti të rëndësishëm, që ka të bëjë me një reformë thelbësore në jetën e vendit, do të mund ta lexojnë atë në mënyrë sa më objektive që t'i qasemi objektivisht nevojës për të përmirësuar këtë draft më tej dhe natyrisht për t'u dhënë qytetarëve shqiptarë, por për të përmbushur atë pritshmëri të madhe ndërkombëtare lidhur me reformën në drejtësi, projektin kushtetues në një kohë sa më të shpejtë.

Sot janë të ftuar edhe ekspertët e nivelit të lartë vendas e ndërkombëtar, që kanë punuar me këtë draft, thjesht për të qenë të pranishëm, për të asistuar, të cilët i falënderoj për punën e madhe që kanë bërë lidhur me projektin kushtetues dhe për prezencën në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm parlamentar.

Në këtë mbledhje dëshiroj të shkëmbejmë opinionet dhe vlerësimet që kemi rreth çështjes për të cilën jemi thirrur.

Kush e do fjalën?

Zoti Halimi.

Eduard Halimi – Draftopiniononi i Komisionit të Venecias, i cili është sjellë para disa ditësh përbën pa dyshim një bazë shumë të mirë për të ecur përpara me miratimin e amendamenteve kushtetuese, si një pjesë shumë e rëndësishme e reformës në drejtësi.

Sigurisht, Partia Demokratike e ka përshëndetur dhe ndihet e inkurajuar nga draftraporti i Komisionit të Venecias, i cili shpresojmë që do të bëhet raport final në ditët në vijim dhe më pas t'u nënshtrohet të gjitha procedurave të mëtejshme. Ky draftraport pa dyshim trajton elemente të rëndësishme të një reforme në drejtësi të qëndrueshme, konsensuale, bazuar në standardet më të mira europiane dhe në një dialog politik.

Është e arsyeshme që kërkesa e qytetarëve për një drejtësi efiçente të vihet në ekzekutim dhe jetë efektive një orë e më parë. Është po aq e arsyeshme, siç e shpreh edhe Komisioni i Venecias në draftraport, që pikërisht ky proces të mos përdoret si një alibi për të kapur drejtësinë nga forcat politike dhe për të garantuar pastaj pandëshkueshmërinë në rastet e korrupsionit.

Ndryshimet kushtetuese, ashtu si edhe vetë Kushtetuta, duhet të jenë para së gjithash një marrëveshje politike mes palëve, me qëllim garantimin e dorëzimit pa kushte të cilido para drejtësisë dhe jo dëshirën për të kapur sistemin e drejtësisë. Jemi të pjesa e metodologjisë dhe qëndrimi i Partisë Demokratike dhe i opozitës në lidhje me këtë proces është që ne duhet të ecim sa më shpejt, të kemi sa më shumë shpejtësi në miratimin e paketës së ndryshimeve kushtetuese dhe duhet, para së gjithash, të fillojmë, në radhë të parë, se nuk kemi filluar ende, dialogun politik për të diskutuar çështjet politike që na ndajnë. Kjo është mbledhja e tretë ose e katërt e reformës në drejtësi, dhe ajo çfarë kanë parë qytetarët shqiptarë nga kjo sallë është që ne jemi bërë një komision korrierësh. Pra, bëjnë drafte ekspertët, na i sjellin ne, ne ia çojmë Komisionit të Venecias, Komisioni i Venecias na i sjell ne, pastaj ju ua çoni ekspertëve tuaj, ne ua çojmë ekspertëve tanë, vijnë përsëri dy drafte dhe i shkojnë përsëri Komisionit të Venecias. Ky është bërë një komision korrierësh dhe unë besoj që qytetarët shqiptarë kanë nevojë për të dëgjuar qëndrimet politike të palëve lidhur me këtë proces. Pse e them këtë? Sepse jemi ne deputetët që japim llogari dhe mbajmë përgjegjësi para qytetarëve shqiptarë. Ne dalim para tyre, do të japim llogari për zgjedhjet që do të bëjmë në këtë Kushtetutë të re që do të ndryshojmë, se ndryshon gati 40% e Kushtetutës. E kam thënë edhe më parë, por po e them përsëri sot, ne nuk mund të fshihemi pas ekspertëve dhe kjo nuk i bën mirë procesit, siç nuk i bën mirë edhe ajo që nuk e

kemi lexuar draftin, por çfarë t'u bëjmë ekspertëve, sepse është çështje e përgjegjësisë politike të partive politike. Nuk është se këtë e themi ne sot, e thotë draftraporti i Komisionit të Venecias shtatë herë, në paragrafët 11, 14, 19, 23, 24, 38, 61 e me radhë: "I takon politikës, u takon ligjbërësve se çfarë vendimi duhet të marrin dhe nuk ua lënë këto çështje ekspertëve për t'i vendosur". Ndaj ne duhet të zgjidhim më parë çështjet politike që thotë Komisioni i Venecias, të mbyllim debatin politik, të gjejmë zgjidhjet më të mira dhe më të qëndrueshme në lidhje me sistemin e ri që do të krijojmë me Kushtetutën e re dhe pastaj kalojmë tek ekspertët. Ekspertët të kalojnë fazën e dytë, ku do të jetë një grup ekspertësh të PS-së, të PD-së, të PR-së, të LSI-së e me radhë së bashku me ekspertët e nderuar të partnerëve ndërkombëtarë, të cilët do të japin alternativa lidhur me problemet, sepse është ngritur një alibi këtu e në media sikur opozita ka vetëm një shqetësim: 2/3 apo 3/5, madje është thënë edhe publikisht se opozita paska paraqitur edhe një draft që i jep fund këtij problemi të opozitës lidhur me problemin e zgjedhjes se anëtarëve të Këshillit të Lartë të Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorisë.

Po e them këtu, kolegët e mi e dinë, nuk e di nëse e dinë edhe kolegët e Partisë Socialiste, për ta bërë të qartë edhe për publikun që çështja e zgjedhjes me 2/3 apo me 3/5 për ne nuk ka asnjë rëndësi. Jo se e themi ne, por e thotë Venecia në paragrafin 14: "Nuk zgjidhet problemi i kapjes me 2/3. Shqetësimi i opozitës, që emërimi i zyrtarëve në institucionet e drejtësisë të bëhet me 2/3, nuk mund ta zgjidhë problemin". Jep rastin e Hungarisë, se mund të ketë edhe raste që maxhoranca është mbi 94 vota. Kjo nuk e zgjidh problemin. Problemi zgjidhet nga arkitektura e sistemit, ndaj 2/3 apo 3/5 është një debat bosh, i cili ose do ta bllokojë sistemin në rast të një opozite destruktive ose do ta çorientojë, siç thotë Komisioni i Venecias, kapjen. Ne nuk kemi ngritur një problem, ne kemi ngritur 10 çështje.

Edhe formulën nuk e kemi sjellë ne, është e vërtetë, reporterët e Komisionit të Venecias gjatë takimit që kemi bërë në këtë sallë propozuan disa nga formulat që ekzistojnë në vendet e tjera për të zgjidhur problemin e kapjes politike, të cilën Komisioni i Venecias në raport e thotë të paktën 10 herë, "nuk zgjidhet as me 3/5 as me 2/3" dhe propozuan disa formula. Këtu kemi qenë, reporterët janë aty dhe ne u thamë se çdo formulë, e cila do të ishte në përputhje me standardet, sigurisht që do të ishte e pranueshme për ne, por nuk paraqitëm formulë, ishin partnerët që për të zgjidhur një nga këto 10 çështje na sollën dy formula, dy modele, pra, nuk i hartuam ne. Secila nga palët mund të zgjidhte një apo dy formula. Kjo është situata lidhur me draftin.

Ajo që dua të them është se nuk është vetëm një çështje politike për të cilën ne ndahemi sot, janë 10 apo 11. Cilat janë ato? Dua t'i bëj të qarta për kolegët dhe për qytetarët që të dinë se ku jemi ne politikisht lidhur me këto çështje.

Së pari, ne nuk jemi dakord, e kemi thënë edhe në shtator, e kemi thënë edhe në dhjetor, e kemi thënë edhe në janar në mënyrë koherente, nuk jemi dakord me ekzistencën dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ju e dini se ato 10 pika ua kemi nisur partnerëve, partnerët jua kanë nisur juve, ju i keni mbi tavolinë. Kanë qenë 54 pika në shtator, morëm disa përgjigje në raportin e dhjetorit, erdhët përsëri me një draft më vete, ua përsëritëm përsëri në shkurt dhe tani këto çështje politike kanë arritur në 10.

Çështja ku ne ndahemi është çështja e emërimeve. Pse nuk jemi dakord me Këshillin e Emërimeve në amendamentet kushtetuese? Pra, nuk jemi dakord me ekzistencën apo me përbërjen e tyre, se mund të gjejmë modele të tjera, pra është çështje që nuk e ndajnë dot ekspertët, se është një organ i vogël elitari, i cili vendoset për nominimin e anëtarëve të KLGJ-së, për të bërë renditjen e anëtarëve të KLP-së, për të bërë renditjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përdoret si një mekanizëm zhblllokues kur palët nuk bien dakord. Kjo përbërje dhe ky funksion, siç është bërë i Këshillit të Emërimeve, përbën një konflikt të dukshëm interesi, aq më shumë që është bërë një këshill që është unik në llojin e vet në këta 25 vjet, por besoj edhe në traditën europiane që është bërë me listë emërore nga mbrapa duke ndjekur kritere selektive në përzgjedhjen e anëtarëve. Ne e kemi thënë publikisht, ju e keni të shkruar, por po e përsëritim për qytetarët: për anëtarët e Këshillit të Emërimeve janë ndjekur kritere selektive, për Gjykatën e Lartë themi gjyqtarin më të vjetër në detyrë, për Gjykatën Kushtetuese themi gjyqtarin më të vjetër në detyrë, për Këshillin e Lartë të Drejtësisë themi anëtarin më të vjetër në moshë, pra ndryshojmë atje. Pse e bëjmë këtë? Sepse këto kritere janë selektive dhe kanë një listë mbrapa, ju i dini emrat, të gjithë i dimë emrat, ne i kemi thënë këtu.

Lidhur me skemën institucionale të propozuar në procesin e emërimit, kjo çështje nuk ka marrë zgjidhje në raportin final. Këto çështje që do të lexoj janë çështje që për ne nuk kanë marrë zgjidhje në raportin final, pra në këtë draft që kemi këtu. Nuk jemi dakord me skemën institucionale të propozuar dhe procesin e emërimit të funksionarëve në sistemin e drejtësisë. Është një arkitekturë e sistemit shumë e komplikuar, e cila nuk kontrollon balancat dhe njëri-tjetrin në organet ku janë ndërtuar. Kjo skemë nuk garanton as pavarësinë e institucioneve, as balanca, madje ka një element shumë të rëndësishëm, i cili nuk është prekur fare, problemi i

korporatizmit, kjo skemë rëndon në favor të korporatizmit në rast se nuk i shërben kapjes, pra në momentin që çmontohet kapja, në momentin kur ikin emrat, kur ikën lista që është bashkëngjitur, që mund të përdoret një sistem tjetër.

Çështja tjetër për të cilën ne nuk jemi dakord ka të bëjë me ekzistencën dhe ngritjen e dy gjykatave të Larta, një Gjykatë të Lartë për Çështjet Civile Penale dhe një Gjykatë të Lartë Administrative. Është korigjuar disi, se thuhet që do të ngrihet mbas katër vjetësh, pra në vitin 2020. Ne vlerësojmë dhe mendojmë se kjo çështje nuk u përket ekspertëve. Kjo çështje i përket politikës, na përket neve ta vendosim. Ne mendojmë që Gjykata e Lartë të jetë një dhe e fuqizuar duke pasur edhe qëllimin për të cilin ajo funksionon: unifikimin e të gjithë praktikës.

Çështja e dytë po për Gjykatën e Lartë për të cilën ne nuk biem dakord është emërimi në Gjykatën e Lartë e gjyqtarëve që nuk janë brenda sistemit. Emërimi i gjyqtarëve jashtë sistemit të karrierës për ne është një çështje që shfrytëzohet politikisht për ta kapur Gjykatën e Lartë.

Çështja e katërt për të cilën ne nuk biem dakord ka të bëjë me hetimin penal nga prokuroria dhe fuqizimin e institucionit të prokurorisë për ngritjen e strukturave hetimore. Bëhet fjalë për Byronë Kombëtare të Hetimit që ne e kemi thënë që në fillim: duhet të jetë brenda sistemit të prokurorisë.

Dua të ndalem pak te pjesa e Byrosë, sepse është shembulli unik kur ne ua lëmë në dorë ekspertëve. Ne jemi dy vjet me vonesë. Kur duhej të ngrihej Byroja e Hetimit? Byroja e Hetimit duhej të ngrihej para dy vjetësh. Është kështu, apo jo? Çfarë ju thamë? Ne bëmë një kërkesë tërësisht racionale, ju thamë Byroja e Hetimit, e cila do të hetojë gjyqtarët dhe zyrtarët e korruptuar, nuk duhet të jetë nën qeverinë. Këtë ju kemi thënë. Vetëm një kërkesë bëmë atëherë. Ne duhet ta ngremë sipas modelit të ardhur nga partnerët ndërkombëtarë, por nuk mund të jetë nën varësinë e Ministrisë së Brendshme, sepse e kupton edhe një fëmijë 10 vjeç që nuk mundet që ata që hetohen ta kenë vetë nënkontroll.

Ne u mbledhëm edhe para tre ditësh, diskutuam për deputetë që kishin përfituar nga fondet publike dhe ju i mbrojtët. Tani mendoni, do t'i lëshoni ju po të keni Byronë? Nuk i lëshoni, se nuk po i lëshoni tani. Jua kërkuam këtë gjë dhe ju thatë që kemi edhe ne ekspertë dhe e miratuat me arrogancë. Ku shkuan? Shkuan në Gjykatë Kushtetuese. Pse duhet të shkonim në Gjykatë Kushtetuese? Nuk kishte nevojë. Nuk e dinin ekspertët tuaj që Byroja nuk mund të jetë brenda organit që heton, brenda Ministrisë së Brendshme, pra hetimin e zyrtarëve ta ketë Ministria e Brendshme? E dinin. Pritëm 6 muaj që të vinte nga Gjykata Kushtetuese. Erdhëm

prapë. Sërisht këmbëngulët që Byroja duhet të jetë përsëri brenda Ministrisë së Brendshme. Pritëm edhe 3 muaj të tjerë, shkuam te Venecia. Erdhi Venecia, dhe vijmë sot e nuk është ngritur ende Byroja e Hetimit. Nuk ngrihet Byroja e Hetimit. Pse nuk ngrihet? Sepse ecim me logjikën dhe fshihemi pas ekspertëve, kështu na thonë ekspertët. Kush është përgjegjës? Keni dy muaj që nuk është ngritur Byroja e Hetimit. Cili është thelbi i të gjithë reformës në drejtësi? Pse po e bëjmë reformën? Ne po e bëjmë reformën për të luftuar korrupsionin te gjyqtarët dhe zyrtarët e lartë. A është kjo? Cili është institucioni që do të hetojë gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e lartë? Do t'i hetojë Byroja. Sot para qytetarëve, kush do të japë llogari pse u vonua dy vjet Byroja. Do të vonohet edhe 6 muaj të tjerë, me sa shoh, sipas parashikimeve, do të ngrihen institucionet e tjera dhe pastaj do të krijohet Byroja e Hetimit. Do të ngarkojmë ekspertët me faj që e kanë vonuar ata? Jo, e kemi ne fajin. Po të kishit dëgjuar opozitën që ditën e parë, me një kërkesë parimore, do të ishte ngritur Byroja pranë Prokurorisë së Përgjithshme. E vonuam dy vjet dhe këtu përgjegjësinë e kemi ne, dhe duhet të themi: po ne e vonuam, na falni, e kishim gabim. E kishit gabim. Këmbëngulët kot.

Çështja e pestë. Nuk jemi dakord me ndërprerjen e mandatave të organeve kushtetuese. Ne e kemi shprehur këtë në qëndrimet tona edhe në shtator, edhe në muajin janar. Këtë e ka thënë qartë edhe Komisioni i Venecias: “Për disa organe kushtetuese, për Prokurorin e Përgjithshëm”, nuk është shprehur për mandatet e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ka vendime të Komisionit të Venecias për rastin e Serbisë, ku e shprehen qartë për këtë çështje. Sigurisht kjo, edhe të gjitha çështjet e tjera, mbeten çështje që, siç e ka thënë Komisioni i Venecias shtatë herë, duhet të jenë çështje, të cilat duhet t’i vendosim në një dialog politik.

Së gjashti, “Nuk jemi dakord me strukturat që do të përfshihen në procesin e vetting-ut, pra rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, dhe mohimin e të drejtës kushtetuese të gjyqtarëve apo prokurorëve për një proces të rregullt ligjor”. Ne e kemi thënë këtë gjë edhe në shtator. Shikoni, ne që jemi dakord me procesin e vetting-ut, e kemi thënë që në fillim. Ka qenë një nga çështjet, për të cilat ne kemi rënë dakord edhe pa u hartuar fare ndryshimet kushtetuese. Unë kam biseduar me drejtuesit e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it, kur m’i kanë paraqitur si variantin e tij çështjet, pa u hartuar ndryshimet, edhe çështjen e SPAKU-t, edhe procesin e vettingut. Unë jam shprehur se jam plotësisht dakord, por duhet të ndiqen dy standardet, standardi i parë është që ata që do të bëjnë vlerësimin të mos jenë të një force politike të maxhorancës, pra duhet të jenë të balancuar, duhet të jenë të pavaruar. Kur themi të jenë të

balancuar, të mos jenë dy deputetë të PS-së apo dy deputetë të PD-së, por duhet të jenë të pavarur nga njëri-tjetri, pra të balancuar, të mos jenë as të PD-së, as të PS-së. E dyta, është të respektohen parimet e Konventës Europiane.

Ju bëtë një draft, i cili binte ndesh tërësisht Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. “T’u heqim të drejtën e animimit. T’u kontrollojmë gjyqtarëve dhe prokurorëve korrespondencën e familjarëve të tyre”. Këtë çështje, për hir të së vërtetës, nuk e ngritëm ne, sepse ne i kushtuam më pak vëmendje, ndoshta mund t’i kishim kushtuar më shumë, por e ngritën gjyqtarët dhe prokurorët. Drafraporti do të thotë se ju keni bërë amendamente, të cilat janë në kundërshtim me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Këtë çështje nuk e zgjidhën dot ekspertët. Nëse doni që të themi se kush nga ekspertët e ka bërë e si e ka bërë, atëherë nuk u kërkohet llogari ekspertëve, kjo është çështje politike që ne duhet ta zgjidhim në mënyrë politike me njëri-tjetrin.

Së shtati, nuk jemi dakord lidhur me procesin e emërimit dhe funksionet e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Në opinionin tonë jemi shprehur se emërimi i Inspektorit të Lartë, me 3/5-t, është një nga çështjet e 3/5 -ve, të cilat me të gjithë anëtarët e Kuvendit për një periudhë 9 – vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje nga radhët e juristëve, e politizon dhe e vendos në vartësinë e pushtetit të maxhorancës qeverisëse, procesin e inspektimit. Jo vetëm kaq, por sërish ju e keni bërë që Inspektori do të inspektohet nga Ministri i Drejtësisë, pra do të jetë nën *hyqmin* e Ministrisë të Drejtësisë, do të jetë nën frikën dhe tutelën e ministrit të Drejtësisë, inspektori që do të inspektojë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. Kjo është çështje, të cilën nuk na e ndajnë ekspertët, këtë çështje duhet ta ndajmë; nëse do ta mbajmë si funksion apo nuk do ta mbajmë, do ta mbajmë si institucion, nëse do ta mbajmë si institucion, çfarë duhet të bëjmë ne që ky institucion të jetë i pavarur, të mos jetë as i njërit as i tjetrit, të jetë një, me një person. Nëse do ta mbajmë, a do t’ia varim xhaketën te zyra e ministrit të Drejtësisë që sa herë ta kontrollojë Ministri i Drejtësisë, ai të bëjë pas, dhe ai të jetë shërbëtor i ministrit të Drejtësisë? Atëherë nuk kemi bërë asnjë gjë, e kemi bërë më keq sistemin. Ne e kemi thënë këtë gjë dhe ia kemi çuar dy herë ekspertëve, kemi vajtur dy herë në Komisionin e Venecias. Nëse do t’u lëmë përsëri ekspertëve këtë çështje, do të vijmë sërish këtu, do të na bëjnë përsëri një draft, do të vejmë sërish në Komisionin e Venecias dhe do të vazhdojmë si me punën e Byrosë, për të cilën kemi dy vjet dhe askush nuk e merr përsipër pse e vonuam, pse e çuam në Gjykatë Kushtetuese, pse e

çuam në Venecia, kur ishte e qartë fare se Byroja nuk mund të jetë nën varësinë e Ministrisë së Brendshme.

Së teti, nuk jemi dakord me përbërjen e Tribunalit Disiplinor. Këtu konstatojmë një përmirësim, në fakt, nga drafti që ka qenë më përpara. Këta reflektohen pjesërisht komision konstatimet e opinionit të ndërmjetëm, por shohim se dhe këtu anëtarët e Tribunalit Disiplinor janë në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo nuk ndihmon një nga çështjet e tjera, nuk ka lidhje me kapjen e drejtësisë, por ka lidhje me korporatizmin. Nuk e shërojmë sistemin nëse nuk vëmë gishtin në plagë, te korporatizmi, po ashtu.

Referimi në ligj i mënyrës së zgjedhjes së tyre lë shteg për abuzime. Ne duhet t'i vendosim çështjet në Kushtetutë si do të zgjidhen, cilët do të jenë anëtarët, kush e ka përgjegjësinë për dështimin, sepse, e themi edhe një herë, nëse ne do të na dështojë Tribunali Disiplinor, më thoni kush do ta marrë përsipër përgjegjësinë, siç dështuam me Byronë? Do të themi që e kishte gabim x-i, se nuk po përmend emrat e ekspertëve, të PS-së apo e kishte gabim eksperti i PD-së, apo e kishte fajin ndonjë tjetër? Ne japim llogari nëse na dështon skema me korporatizmin, me Tribunalin Disiplinor, nuk do të arrijmë dot të luftojmë korrupsionin e të largojmë gjyqtarët e korruptuar në prokurorët do të dalim ne të themi që e kishim gabim dhe do të marrim koston nga qytetarët.

Së nënti, lidhur me Gjykatën Kushtetuese, ne nuk jemi dakord me formulën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi, si dhe kërkojmë respektimin e parimit të superkonstitucionalitetit. E thotë Komisioni i Venecias, por e kemi thënë disa herë. Komisioni i Venecias thotë se ka tradita në vende të ndryshme, Gjykata Kushtetuese mund t'i hyjë themelit, mund të mos i hyjë themelit, mund t'i hyjë procedurës, mund të mos i hyjë procedurës, por ama, në paragrafin e fundit, për Gjykatën Kushtetuese, Komisioni i Venecias shprehet qartë: "Në rastin kur Gjykata Kushtetuese duhet të shikojë procedurën, ne biem dakord me këtë, duhet patjetër që të shikohet edhe përputhja me parimet". Se, ja i thamë ne parimet, i kishit hequr të drejtën gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'u ankuar në Gjykatë Kushtetuese. Por kjo është e paimagjinueshme, kjo nuk ndodh askund që t'i heqësh të drejtën për t'u ankuar në gjykatë. Kjo të nxjerr jashtë Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përveç një procesi të rregullt, ka edhe të drejtën e ankimimit, por ju ia kishit hequr. Tani, Gjykata Kushtetuese, a duhet ta diskutojë këtë gjë? U kemi thënë tri herë ekspertëve. Ekspertët tuaj kanë bërë një model tjetër, ne model tjetër, dhe ja ku jemi sërish këtu.

Së dhjeti, nuk jemi dakord me përfshirjen në sistemin gjyqësor të individëve, të cilët nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Kjo është një çështje që, në fakt, ne kemi 10 vjet që e diskutojmë. Keni ngulur këmbë që në vitin 2007. Donit patjetër, e vutë kusht në parlament, që të kemi 10% të atyre që nuk kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës të futen në Shkollën e Magjistraturës. Në opozitë ishit, nuk e kuptova pse e bëtë, tri orë ka vazhduar atëherë parlamenti. Ne dy herë e kemi sjellë draftin atëherë dhe kemi thënë: zero hyrje nga jashtë Shkollës së Magjistraturës. Cili është efekti? Të dalim tani para qytetarëve e t'u japim përgjigje nëse kanë hyrë, po kanë hyrë. Kush e ka shfrytëzuar këtë hendek? Ata që janë përgjegjës. Ne duhet të jemi përgjegjës para qytetarëve. Ne i krijuam dritaret, ne thamë që futni disa edhe nga dritarja. A janë gati organet e sistemit të drejtësisë të përfitojnë nga hapësirat që i lëmë ne? Po, edhe kanë përfituar.

Ndaj dhe sot, për të qenë përgjegjës para qytetarëve, themi që duhet të ketë zero hyrje nga jashtë Shkollës së Magjistraturës. Pse? Sepse Shkolla e Magjistraturës ka treguar integritet në momentin e përzgjedhjes të kandidatëve, duke lënë mënjanë kriteret politike, hatëret, miqësitë. Ka një provim në Shkollën e Magjistraturës, i cili ka qenë me integritet, me sa mbaj mend unë, në këto 19 vjet, që kur është bërë provimi i parë. Duhet t'i qëndrojmë këtij parimi që nuk duhet të ketë as edhe një hyrje nga Shkolla e Magjistraturës. Ne e kemi bërë këtë debat, ju nuk e keni pranuar, ua kemi thënë ekspertëve dhe vijmë prapë këtu. Komisioni i Venecias ka thënë: "E mirëpresim, ashtu siç e keni bërë për prokurorët, të cilët nuk duhet të jenë jashtë Shkollës së Magjistraturës, edhe gjyqtarët nuk duhet të vijnë jashtë Shkollës së Magjistraturës. Por për këtë çështje duhet të bimë dakord.

Së fundi, ne nuk jemi dakord me procedurën e emërimit të anëtarëve jo gjyqtarë dhe jo prokurorë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Pra, janë 5 anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe 5 anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të cilët zgjidhen nga politika, nga parlamenti. Me atë mënyrë siç e keni formuluar ju, ne nuk jemi dakord. Nuk jemi dakord as me çështjen 2/3-at apo 3/5-at, por duhet të ndjekim ato rekomandime që jep Komisioni i Venecias me formulime, të cilat duhet të garantojnë atë shqetësim të ligjshëm që ka opozita këtu dhe opozita në çdo vend, sepse, para së gjitha dhe mbi të gjitha, Kushtetuta duhet të garantojë besimin reciprok të palëve. Ne kemi probleme në këtë proces, prandaj jemi këtu, prandaj kemi që në shtator dhe vijmë vërdallë, shkojmë në Venecia, vijmë këtu, jemi bërë korrierë, ndërkohë që duhet të jemi përgjegjës, duhet të dalim para

qytetarëve dhe të themi se jemi përgjegjës. Ne të gjithë këtu jemi juristë dhe duhet të marrim vendime, të diskutojmë njëherë politikisht për çështjet politike se cilat janë, pastaj të kalojmë te çështjet teknike, sepse, të paktën, nga rreth 89 paragrafë, që ka Komisioni Venecia II (po e trajtoj Venecia I dhe Venecia II), në 46 prej tyre Venecia rrëzon draftin e paraqitur nga qeveria, 20 prej tyre janë deklarative dhe në pjesën tjetër janë çështje teknike që përfshihen si sugjerime. Të 46 çështjet e ka ngritura, të cilat janë ngritur ose opozita, ose i kanë ngritur palët e tjera politike, ose grupet e interesit. Sigurisht që çështjet e tjera, që nuk i ka trajtuar Venecia, jo se i ka miratuar, ta keni të qartë këtë gjë, por nuk i ka trajtuar thotë Venecia në paragrafin 8: “Për aq kohë sa ato janë çështje që nuk janë të diskursit politik”.

Cilat janë 46 çështjet për të cilat Komisioni i Venecias rrëzon draftin? Janë të pakët 10 çështje politike, të cilat opozita i ka ngritur, unë i lexova pak më parë, të cilat i kemi ngritur dhe në letrën që jua kemi sjellë juve:

Në lidhje me çështjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, e përqendruar në kapitullin D, Komisioni i Venecias i ka dhënë fund diskutimit, duke e bërë të qartë se hetimi i korrupsionit politik në nivelin e zyrtarëve të lartë duhet të jetë i pavarur dhe jo nën qeverinë. Këtë çështje, thashë, e trajtova dhe nuk dua t’i kthehem më.

Në 10 paragrafët që i përkasin seksionit “B” “Emërimi i organeve të përhershme që sigurojnë pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit” Venecia II, ka rrëzuar draftin qeveritar, i cili synonte t’i emëronte këto organe vetëm me votat e maxhorancës, duke pranuar shqetësimin racional dhe të kuptueshëm prej Venecias se kjo ishte një skemë kapjeje. Venecia ia ka lënë këto 10 paragrafë për diskutim, ligjvënësit, ia ka lënë çështjeve politike.

Janë tre paragrafë të seksionit 2 “Zgjedhja e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm”, të cilët kanë rrëzuar tërësisht draftin e qeverisë, duke e thënë hapur se shqetësimi për kapjen ishte real duke i dhënë të drejtë opozitës. Në 7 paragrafë të pikës 4, seksioni “B” kanë rrëzuar sërish qeverinë për rolin absurd të Ministrisë të Drejtësisë në kontrollin e drejtësisë dhe parimeve bazë që shkelen gjatë një procesi gjyqësor. Gjithashtu, tre paragrafë të seksionit “C” për Gjykatën Kushtetuese, sërish kanë rrëzuar draftin e qeverisë, duke i cilësuar “shumicë të cilësuar” nga “shumica e thjeshtë”, tre paragrafë të seksionit “F” që kanë të bëjnë me vetingun, 6 paragrafë të seksionit “H”, që kanë të bëjnë me të drejtën e gjykatësve për t’u ankuar; 3 paragrafë në seksionin “I”, me statusin që rrëzojnë draftin dhe 9 paragrafë të seksionit

“J”, ku rrëzohet drafti i qeverisë për ndërprerjen e pakuptimtë, sipas Venecias, të mandateve të institucioneve kushtetuese.

Këto pra janë, pak a shumë, çështjet, për të cilat flet Komisioni i Venecias, çështje, të cilat i ngre Partia Demokratike, janë çështje që nuk kanë marrë përgjigje nga diskutimi me ekspertët. Këto çështje kthehen, duke e përfunduar, në çështjen e metodologjisë si mund të ecim më shpejt, si ne të mos përsërisim metodologjinë e gabuar për Byronë Kombëtare të Hetimit, ku sot askush nuk del përgjegjës të mbajë përgjegjësinë pse e vonuam dy vjet, sepse nuk është çështje ekspertësh, është çështje e përgjegjësisë politike të deputetëve.

Ndaj, për të ecur më shpejt, për të mos pasur atë eksperiencë të gabuar, e cila u pa me Byronë Kombëtare të Hetimit, për të mos pasur atë eksperiencë të gabuar, e cila u ndoq me procesin e hartimit në mënyrë të njëanshme, ecjes në mënyrë të njëanshme nga ana e qeverisë, kur ekspertët tuaj bëjnë një draft, ekspertët tanë bëjnë kundërshtime, shkojnë në Venecia, vijnë prapë këtu dhe vijnë vërdallë dhe ne si komision bëhemi korrierë, unë sugjeroj të vazhdojmë diskutimin e këtyre 10 çështjeve, t'i diskutojmë, të biem dakord 10 apo 11 çështje, sa të jenë, nëse kemi ne, nëse kanë të tjerët, hajde t'i bëjmë një tabelë dhe të themi: këto janë 10 çështjet për të cilat ne nuk biem dakord, mund të biem dakord për 4 apo 5 çështje, mund të mos biem dakord për 5 çështje të tjera, të vazhdojmë dialogun për këto 5 të tjera, të cilat janë tërësisht parimore. Të gjitha çështjet janë të gjitha parimore, që i shërbejnë një reforme jetëgjatë në drejtësi. Të vazhdojmë sot, me media pa media, të vazhdojmë nesër, pasnesër, deri kur të vijë raporti i Komisionit të Venecias, në mos gaboj me 11 apo 12 mars, për seancën plenare. Të mbyllim diskutimin politik që kemi për këtë çështje, se ekspertët nuk na e zgjidhin dot hallin politik.

Pasi të mbyllim diskutimin politik për çështjet, ua kalojmë ekspertëve në një fazë të dytë, të cilët marrin çështjet e debatit politik, marrin çështjet të cilat kanë gjetur mbështetje në Komisionin e Venecias, lidhur me draftin e amendamenteve kushtetuese dhe ndërtojmë një draft amendamentesh sa më shpejt, që javën e ardhshme, i cili të jetë konsensual dhe të mos vijmë vërdallë sërish me historinë e ekspertëve apo historinë e të bërit të korrierit.

Sugjerimi im, edhe një herë, është të diskutojmë pikërisht për çështjet politike, për këto 10 çështje, çfarë mendimi keni ju, i pranoni, nuk i pranoni, për të gjitha çështjet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj- Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Të jem i sinqertë, unë mendova që sot ne do të procedonim në mënyrë të ndryshme, por, pasi dëgjova diskutimin e parafolësit, u qartësova për një varg problematikash.

Çfarë prisja unë sot? Ne jemi një komision, që kemi çuar për herë të dytë në Komisionin e Venecias një dokument të ridiskutuar, në bashkëpronësi edhe me ekspertizën ndërkombëtare, të diskutuar në publik, me të gjitha trupat gjyqësore të mundshme, që kemi pasur mundësi të realizonim, me pyetje dhe përgjigje dhe sigurisht me pëlqimet dhe mospëlqimet përkatëse. Nëse do të ecnim me logjikën se ka një problem politik, për të cilin palët duhet të diskutojnë politikisht reformën e drejtësisë, po, ka pasur një problem politik dhe ky ishte në fazën e parë: pjesëmarrja e opozitës në komision. Nëse do të diskutonim nëse ka pasur një problem politik për reformën në drejtësi, themi: po, ka pasur një problem politik dhe, ky problem, në eksperiencën time të të parit të politikës, ka qenë nëse palët do të ishin dakord për të bërë një reformë drejtësie. Përfaqësuesit më të lartë të të dyja palëve, janë shprehur në publik se janë dakord për të zhvilluar reformën e drejtësisë.

Çështje të tjera politike të them të drejtën, nuk di, të paktën, nga pamja e të parit politikisht problemit. Ne jemi deputetë të një komisioni parlamentar, me një mandat të caktuar për të zhvilluar një diskutim, i cili na vendos përpara disa detyrimeve: të shprehemi pro apo kundër një materiali të caktuar.

Sot, të dashur kolegë, ne kemi një material, po e përsëris, në bashkëpronësi me përfaqësuesit e ekspertizës së Bashkimit Europian dhe SHBA-ve, i cili ka shkuar dy herë si material dhe të dyja herët Komisioni i Venecias është shprehur për këtë material.

Sot unë dëshiroj ta falënderoj përfaqësuesin e opozitës që të paktën ne sot marrim vesh, në mënyrë të qartë, publike, për çfarë nuk jemi dakord dhe po i lexoj, të pakët, ashtu siç i kam kuptuar unë:

1. Nuk jeni dakord për ekzistencën e funksionimit të Këshillit të Emërimit të Drejtësisë.
2. Nuk jeni dakord për ekzistencën e Gjykatës së Lartë Administrative, të dy Gjykatave të Larta, si edhe me prurjen jashtë sistemit gjyqësor në Gjykatën e Lartë.
3. Nuk jeni dakord me ekzistencën e Prokurorisë Paralele.
4. Nuk jeni dakord me ndërprerjen e mandateve të organeve kushtetuese ekzistuese.
5. Nuk jeni dakord me strukturat që do të kryejnë procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe mohimin e së drejtës kushtetuese të tyre për një proces të rregullt ligjor. Kjo më

duket shumë e rëndësishme, sidomos pas daljes së lajmit të listës së zezë të ambasadës amerikane, shpresoj edhe nga Bashkimi Europian, së shpejti.

6. Nuk jeni dakord me procesin e emërimit dhe funksionit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

7. Nuk jeni dakord me përbërjen e Tribunalit Disiplinor.

8. Nuk jeni dakord me formulën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi dhe respektimit të parimit të superkonstitucionalitetit.

9. Nuk jeni dakord me përfshirjen në sistemin gjyqësor të individëve, jashtë rregullave normale të përfundimit të Shkollës së Magjistraturës.

10. Nuk jeni dakord me procedurën e emërimit të anëtarëve jo gjyqtarë, jo prokurorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në respekt të kolegëve, mendoj se në çdo rast këto nuk janë çështje politike, këto janë çështje teknike. Sot, në mënyrë publike dhe zyrtare, i ratë ndesh gjithë asaj që ne konsiderojmë strukturë të reformës së drejtësisë, të bëra jo si reformë e 60 votave të Partisë Socialiste, që do të bëjnë namën dhe do të kapin sistemin, por e një reforme në bashkëpronësi me ekspertizën e Bashkimit Europian dhe SHBA-ve. Këto 10 “nuk” krijojnë një problem shumë të madh politik, sepse unë tani nuk e di se kë duhet të besojmë, duhet të besojmë kryetarin e Partisë Demokratike, i cili del në oborrin e partisë së tij dhe duke nxjerrë raportin e Komisionit të Venecias thotë: “Ky është *road map*-i, kjo është rruga, ky është dokumenti mbi të cilin ne do të ecim”. Sot sollët një dokument tjetër me 10 “nuk”, ku rrëzoni të gjithë strukturën e reformës dhe që nuk jeni dakord për këtë, për këtë dhe për këtë.

Sot, të dashur kolegë, nuk kemi çfarë të diskutojmë politikisht, por do të kemi mundësinë që në ekspertizë t’i diskutojmë nën për nën këto 10 “nuk”-et që keni hedhur në tavolinë, në mënyrë zyrtare, sot për herë të parë dhe që rrëzojnë strukturën e reformës.

Po e përsëris edhe një herë: ky qëndrim është shterues, është fundor, është politik. Ne duhet të besojmë atë që keni thënë pas deklarimit të Komisionit të Venecias, se kjo është ajo që Partia Demokratike do t’u qëndrojë deri në fund, apo këtyre 10 “nuk”-ve, të cilat janë ekspertizë teknike? Të gjitha këto së bashku përbëjnë një problem politik, i cili realisht nuk mund të negociohet, sepse me këtë problem politik që na keni ardhur sot ju thoni se reformë në drejtësi nuk ka.

Më falni për mungesën e diplomacisë apo të shprehurit në mënyrë politike, por mendoj se gjërat e thjeshta janë më të qarta kur thuhet me një gjuhë më të ashpër. Këto propozime që na keni sjellë sot thonë qartazi: reformë në drejtësi në Shqipëri nuk ka.

Faleminderit!

Eduard Halimi - Kam vetëm një pyetje.

Fatmir Xhafaj - Jo, nuk ka pyetje, ka vetëm diskutime.

Eduard Halimi - Zoti Fatmir, të lutem!

Fatmir Xhafaj - Në rregull, për procedurë!

Eduard Halimi - Zoti Majko foli për ato çfarë ka thënë Komisioni i Venecias, ku ka folur për dialog politik, si dhe për këto çështje që hidhen në erë dhe se po thuhet për herë të parë. E mira është që kolegët dhe zoti Majko t'i lexojnë ato që shkruhen para se të vijnë këtu.

E para, opozita nuk ka ngritur 11 pika, por 54 pika që në shtator, ku përfshiheshin edhe këto 11 pika. Ju duhet të kishit durimin të lexonit edhe ato çfarë shkruajnë ekspertët tanë, jo vetëm se çfarë shkruajnë ekspertët tuaj.

E dyta, të njëjtat çështje u ngritën edhe në janar kur ishim këtu dhe nuk i ngritëm sot. Në janar kemi ngritur 42 çështje, në të cilat përfshiheshin edhe këto të 11-ta, zoti Majko, por ato erdhën duke u reduktuar për faktin se Komisioni i Venecias disa i ka hequr dhe u ka dhënë përgjigje.

Sot ju thoni: çfarë është ky debat politik? Këtë nuk po e kërkojmë ne, por ta thotë 7 herë Komisioni i Venecias. E ke lexuar raportin e Komisionit të Venecias apo ke dëgjuar vetëm se çfarë themi në televizor? Ne kemi thënë që e mbështesim një më një, në çdo pikë, raportin e Komisionit të Venecias 2.

Çfarë thuhet në raportin e Komisionit të Venecias? Thuhet 7 herë “dialog politik”. Për kë e thotë këtë dialog politik, zoti Majo? E thotë për këto çështje që ngrita unë. Po ku e thotë këtë, zoti Majko, që t’ua themi qytetarëve? Në paragrafin 11 thuhet: “Nga pikëpamja teorike është e vështirë të thuhet se cilat nga këto institucione, nga arkitektura do të ishte e nevojshme, por i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë sistemin e kontrollit dhe të ekuilibrave”.

Kush është ligjvënësi shqiptar që do të bëjë raportin e ekuilibrave? Ne jemi. Kujt ia lë Komisioni i Venecias? Na e lë neve. Çfarë thotë Komisioni i Venecias në paragrafin 13? Në paragrafët 13 dhe 14 thuhet: “Këto çështje, çështja e zgjedhjes së anëtarëve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë...”.

Pse çështje politike është kjo, zoti Majko? Po ta thotë “Venecia”. Kush po i bie në ballë “Venecias”? Po e thua ti: “Nuk pyes për Venecian”.

Venecia thotë: “Kjo çështje u përket palëve politike, që duhet ta vendosin me një dialog politik”. Çfarë thamë ne? Ne thamë që çështjen e emërimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk duhet ta ketë vetëm maxhoranca, dhe kjo është 1 nga 10 çështjet. Ti thua: “Po, pse çështje politike është kjo?”. Po ta thotë 7 herë Komisioni i Venecias: “Këto çështje i zgjidhin në nivel politik”.

Ti thua: “Po mirë, pse ankoheni ju tani për të drejtat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve?” Po pse mund ta thuash ti një gjë të tillë?

Ti thua: “Çfarë është kjo? Ku e keni hallin?” Çfarë halli kemi ne? Ne nuk kemi asnjë hall, por që Kushtetuta t’i bie në ballë Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, këtë nuk e themi ne, por këtë ta thotë “Venecia”: “Shkel nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut”

Në përfundim, Venecia thotë 7 herë “dialog politik” për 7 çështje. 11 janë çështjet, të cilat përfshihen në këto 7 çështje të debatit politik. Nëse doni Venecian, referojuni 7 herë çështjeve që ngre Komisioni i Venecias për dialog politik. Nëse ju thoni: “Neve nuk na duhet dialog politik, se këtu do të jemi dhe do të ecim vetëm,” atëherë lërjani punën Komisionit të Venecias.

Kjo është e qartë. Ecni si me Byronë.

Fatmir Xhafaj - Do t’ju lutem, respektoni njëri-tjetrin, që secili të ketë mundësi të flasë. Mos bëni komente mbi atë që thotë tjetri, se pastaj njerëzit nuk do të kuptojnë se cilat janë qëndrimet e grupeve politike, në rastin konkret, dhe qëndrimet individuale.

Do t’ju lutem, ruajmë një lloj rendi në komunikimin e mbledhjes.

Po, zoti Mediu!

Fatmir Mediu - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Patjetër që duhet ta dëgjojmë me vëmendje njëri-tjetrin dhe duhet të ndjekim të gjithë historikun e kësaj reforme për të kuptuar se çfarë është mendimi i ekspertëve dhe cila është marrëdhënia politike që duhet të krijojmë me njëri-tjetrin.

Opozita, Partia Demokratike dhe Partia Republikane, e ka bërë të qartë qëndrimin, që kjo reformë në drejtësi të jetë një marrëdhënie dhe një marrëveshje politike, që t’i shërbejë një

pushteti gjyqësor të pavarur. Si udhërrëfyese për këtë gjë kemi parë rekomandimet dhe draftrekomandimet e Komisionit të Venecias dhe kjo është baza mbi të cilën jemi referuar.

Pavarësisht nga opinionet e ndryshme që kemi pasur, të cilat u shprehën edhe këtu, vlerësimet për punën e ekspertëve të nivelit të lartë apo të ekspertëve të tjerë, të cilët dua t'i falënderoj për punën që kanë bërë, ne kemi pasur edhe opinione të ndryshme mbi çështjet. Sot, të paktën kemi 3 materiale bazë, mbi të cilët mund të diskutojmë politikisht, se nuk jemi as më shumë dhe as më pak veçse përfaqësues politik.

Në qoftë se në draftrekomandimet e Komisionit të Venecias flitet për marrëveshje politike, kjo do të thotë se që ky komision dhe më tej parlamenti, Kuvendi i Shqipërisë, të arrijnë të gjejnë gjuhën për ato gjëra që nuk hyjnë thjesht me diskutime teorike, teknike dhe juridike të çështjes, por kërkojnë një mirëkuptim të të gjitha palëve.

I marrim me radhë: është materiali i paraqitur nga ana juaj në Komisionin e Venecias, ku ju keni qenë dakord; janë vërejtjet që ka bërë grupi i ekspertëve të opozitës, që, siç tha edhe zoti Halimi, kanë qenë 56 vërejtje, të cilat i kemi pasur në fillim, por tani jemi në 11 vërejtje, madje një pjesë e këtyre vërejtjeve janë ezauruar tashmë me qëndrim të prerë, të hapur, të Komisionit të Venecias në qoftë se do të lexojmë draftrekomandimet.

Nëse duam të jemi produktivë, është mirë që ta nisim pikërisht aty kemi diferenca. Kjo që po shtrojmë sot është që t'i marrim çështjet një nga një, të shikojmë se ku kemi gjykim të përbashkët, ku janë diferencat dhe ai grup ekspertësh që duam të ngremë, nga të gjithë përfaqësuesit e partive politike që janë këtu, të arrijë të gjykojë pikërisht mbi pretendimet tona dhe të mos të bëjmë të kundërtën, sepse nuk do të kemi asnjëherë produktivitetin që duhet të kemi. Pra, e thënë thjesht, ne si opozitë, në mënyrë të padiskutueshme, duam që kjo reformë të bëhet sa më e plotë dhe sa më e drejtë, duke respektuar rekomandimet e Komisionit të Venecias, ashtu siç do të donim, nga ana juaj, që ato shqetësime të ngritura nga ne, konsiderojeni ju të drejta ose të padrejta, minimalisht të kenë vlerësimin tuaj dhe të lexohen.

Nuk janë thjesht “nuk-e” dhe “nuk duam këtë”. Zoti Halimi u përpoq shkurt të shpjegonte që për 11 çështjet që ngriti se cilat janë pretendimet, në ekzistencën e një strukture apo në funksionimin e një strukture, në kriteret e emërimit apo në kriteret e vlerësimit të anëtarëve që do të jenë pjesë e tyre apo të procedurave që duhen ndjekur. Ata ekspertë, siç vlerësuam ne, analizuan punën e ekspertëve të huaj, është mirë që edhe ju të vlerësoni punën e ekspertëve tanë. Është mirë që nga 56 çështjet dhe qëndrimet e ndryshme, tashmë jemi te 11

madje më pak se 11 po t'i referohemi draftit rekomandimit të Komisionit të Venecias. Pra, le ta fillojmë këtë diskutim politik, sepse jemi përfaqësues politik, ta ngremë edhe atë grup teknik që të bëhet funksional dhe në bazë të saj të arrijmë sa më shpejt në përfundime, që kjo reformë të marrë atë rrugë që duhet.

Ndonjëherë ne jemi larg më shumë në pretendime dhe deklarime se ç'jemi larg në thelbin e asaj çfarë duam të arrijmë.

E mbyll këtu dhe duhet ta dëgjojmë njëri-tjetrin me vëmendje, të vlerësojmë qëndrimet dhe deklaratimet reciproke të palëve që janë pjesë e kësaj tryeze dhe e këtij komisioni.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Mediu!

Kush e do fjalën? Po, Zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Para së gjithash do të doja shumë të vlerësoja punën e ekspertëve të nivelit të lartë. Më vjen mirë që Komisioni i Venecias, qoftë në hyrje të raportit të tij, por edhe në fund, konkretisht në paragrafin 86, përgëzon në mënyrë të veçantë ekspertët e komisionit parlamentar për punën që kanë bërë dhe mbi të gjitha për përgatitjen e reformës, duke marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e bëra në raportin e parë.

Duke dëgjuar kolegët të krijohet përshtypja sikur nuk kemi një raport të dytë të Komisionit të Venecias, i cili vë në dukje qartë se projektndryshimet që i ka paraqitur grupi i ekspertëve të nivelit të lartë kanë ndryshime shumë të rëndësishme, jo vetëm në detaje, por edhe në lidhje me zgjedhje të rëndësishme parimore. Komisioni thekson se mbeten disa probleme teknike.

Unë si anëtare e Komisionit të Reformës në Drejtësi mendoj se kur flitet për probleme, mbetemi te disa probleme teknike, të cilat nuk duhet të jenë të pazgjidhshme, siç shprehet Komisioni i Venecias në paragrafin e 8, por kjo është një punë shumë e qartë se kush duhet ta zgjidhë pikërisht këtë problematikë.

Nga ana tjetër, ashtu sikurse jemi mësuar shpesh të dëgjojmë, do të doja që në Komisionin e Reformës në Drejtësi të mos lexohen në mënyrë gjysmake paragrafët ose rekomandimet e Komisionit të Venecias, pra, të lexohet pjesa e parë e fjalisë dhe të mos lexohet pjesa e dytë.

Ajo që dua të theksoj është se Komisioni i Venecias në paragrafin 88 të tij ka përcaktuar pikërisht 5 rekomandime, të cilat duhen zgjidhur nga komisioni ynë. Ndërkohë, nga shumë

çështje njëra prej tyre ka qenë kauz e opozitës gjatë kësaj periudhe, ajo e 2/3-ve ose 3/5-ve, çështje, e cila nuk është theksuar asnjëherë te paragrafi 55, nga ku është përmendur dhe është folur gjerë e gjatë.

Këtu u përmend paragrafi 14 i raportit të Komisionit të Venecias lidhur me 2/3-at apo me 3/5-at. Komisioni i Venecias thekson se nuk ka dashur të thotë pikërisht këtë kur ka përmendur një gjë të tillë. Ajo që është për t'u theksuar dhe që duhet bërë e qartë, edhe për ata që na ndjekin, në këtë raport Komisioni i Venecias jep disa alternativa, disa zgjidhje të problemeve, të cilat kanë qenë të debatueshme dhe të diskutueshme, duke marrë shkas edhe nga shqetësimet që kanë ngritur kolegët e LSI-së apo edhe të Partisë Demokratike. Pra, Komisioni i Venecias këtu jep disa zgjidhje ose disa formula, të cilat, në fund të fundit, do t'i diskutojmë këtu në komision.

Ajo që dua të theksoj është vlerësimi i veçantë që meritoni ju, si anëtarë të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, qoftë vendas dhe të huaj. Njëkohësisht, vlen të përmendim edhe faktin se në tërësi teksti i dokumenteve që ju keni paraqitur është gjetur koherent dhe në përputhje me standardet evropiane.

Sinqerisht, në fillim të mbledhjes nuk po kuptoja se për cilin tekst po flitej dhe ku gjendeshin të gjitha ato vërejtje dhe kritika, ndërkohë që paragrafin 87 të raportit të Venecias thuhet se teksti në tërësi është koherent dhe në përputhje me standardet evropiane. Komisioni i Venecias beson se projektndryshimet mund të finalizohen pa vonesa dhe t'i paraqiten për votim parlamentit. Pra, në ka qartësi se si është shprehur Komisioni i Venecias në këtë raport, besoj se e shpreh shumë qartë paragrafi që unë sapo lexova.

Mua më vjen mirë që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka mundur të marrë një nga një të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e bëra në raportin e parë të Komisionit të Venecias, atë që quhet raporti paraprak, dhe që me të drejtë Komisioni i Venecias i ka gjetur me vend.

Pa dyshim kisha menduar se në këtë mbledhje, në radhë të parë, do të shprehnim mirënjohjen dhe vlerësimin për të gjithë punë e bërë, të falënderonim në mënyrë të veçantë ekspertë ndërkombëtar, të cilët kanë prodhuar së bashku me ekspertët shqiptarë një produkt shumë të mirë. Nga ana tjetër, të inkurajonim pikërisht vazhdimin e këtij procesi, sidomos të përgatitjes, sikurse shprehet Komisioni i Venecias në paragrafin 89, të të gjitha punëve legislative që kërkon kjo reformë me vazhdimin e një fryme të dialogut konstruktiv dhe respektimit të vlerave, praktikave më të mira evropiane. Me fjalë të tjera, këtu nuk bëhet fjalë për

atë që ne themi, që reforma në drejtësi të jetë produkt i një marrëveshjeje politike. Unë nuk e lexoj raportin e Komisionit të Venecias ku përmendet fryma e dialogut konstruktiv si marrëveshje politike.

Marrëveshja politike do të thotë pazarllëk, më jep, të jap, ndërkohë që në raportin e dytë të Komisionit të Venecias janë parashtruar disa alternativa për ato probleme që ju i keni konsideruar si probleme politike. Në fund ne mund të përcaktojmë dhe të përzgjedhim se cila do të ishte formula më e mirë ose modeli më i mirë në kushtet e Shqipërisë.

E fundit që dua të theksoj. E gjithë kjo punë që është bërë deri më sot dhe i gjithë stafi që ka punuar në mbështetje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe të huaj nuk mund të hidhet poshtë me atë listë, që me të drejtë kolegu im Majko tha: “Nuk jemi dakord me këtë, nuk jemi dakord me atë”. Shumë nga gjërat që ju thatë se nuk ishit dakord unë i mora dhe i nënvizova përsëri dhe nuk i gjej në raportin e Komisionit të Venecias.

U përpoqa që këto “nuk” t’i kaloja paragraf më paragraf, për të parë se ku i kanë gjetur kolegët. Mendoj se në këtë fazë ne nuk duhet t’i kthehemi më raportit ose draftit të parë që prodhoi grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, por duhet të ndalemi dhe të vazhdojmë te stacion ku kemi mbërritur, pra te raporti i dytë, derisa të vijë raporti final, besoj në mes të marsit, si ne mund të marrim në konsideratë dhe të përshpejtojmë hapat për të mbyllur dhe për të finalizuar këtë proces.

Cilat janë gjërat për të cilat do të punojnë ekspertët e nivelit të lartë dhe cilat janë gjërat, për të cilat më pas, kur ata të sjellin një produkt, ne t’i diskutojmë midis ekspertëve që do të përcaktojnë partitë politike, por kurrësi për ta politizuar gjithë këtë proces.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Ristani!

Arben Ristani - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, çdo punë e ndershme duhet respektuar dhe duhet falënderuar! Ne thjesht nuk e nisëm me falënderime, sepse nuk e kishim në rend të ditës, por sigurisht puna e ndershme duhet falënderuar, ashtu si ekspertët e opozitës, si ekspertët e huaj dhe të gjithë ata që kanë punuar në mënyrë të ndershme meritojnë falënderime.

Për sa i përket themelit të çështjes, më vjen keq që kur kërkohet konsensus quhet pazarllëk. Po të vendoset në mënyrë të njëanshme qenka drejtësi, por nëse kërkohet konsensus që të bisedohet nga të dyja palët qenka pazarllëk. Kjo është e padrejtë, e pavërtetë dhe jo dinjitoze.

Parlamenti i Shqipërisë na ka ngarkuar ne si komision që të hartojmë draftin e reformës në drejtësi. Pra, detyra dhe përgjegjësia e këtij komisioni parlamentar është e ndërtuar nga të dyja krahët e parlamentit, edhe të maxhorancës, edhe të opozitës. Prandaj jemi këtu së bashku, që të bisedojmë së bashku, të gjejmë gjuhën së bashku dhe të shkojmë para parlamentit me një draft të përpunuar. Në rast se ju mendoni se duhet vetëm mendimi juaj dhe yni nuk vlen, se përndryshe po u mor mendimi ynë quhet pazarllëk, ky është një paragjykim që nuk vlen për ecurinë e kësaj tryeze.

Kemi ngritur grupet e ekspertëve, që normalisht duhet t'ua kishim lënë ne detyrat që në fillim, por edhe në këtë rast u veprua në mënyrë të njëanshme. Gjithsesi, ekspertët e maxhorancës, ekspertët e opozitës dhe ekspertët ndërkombëtarë dhanë mendimin e tyre. Shkuam dy herë edhe në Komisionin e Venecias, ku morëm edhe mendimin e tyre. Pra, gjërat janë shoshitur, janë rrahur në nivel ekspertësh dhe tani vijmë në këtë tavolinë, që ta diskutojmë ne si anëtarë të komisionit.

Nga të gjitha mendimet dhe opinionet e fundit të Komisionit të Venecias na ngelen këto 10 apo 11 pika, të cilat duhen diskutuar. Ne i renditëm dhe ia vlejnjë të diskutohen, pasi për ne janë të rëndësishme dhe të qenësishme për drejtimin që do të marrë reforma. Meqenëse duhet ky lloj bashkëpunimi dhe ky lloj konsensusi, çfarë të keqe ka që ne t'i diskutojmë këto problematika, se ndoshta biem dakord me njëri-tjetrin, të shohim në çfarë alternativash kemi para dhe pastaj për formulim teknik pyesim ekspertët.

Ne do ta zgjidhim dhe do ta vendosim së bashku këtë punë, nëse do të vendosim në sistem jashtë Shkollës së Magjistraturës apo jo, në rast se po, le ta vendosin ekspertët se si do ta shkruajmë ligjin.

Pse të mos e diskutojmë së bashku? A duhet ta hapim jashtë Shkollës së Magjistraturës? A duhet të çojmë në Gjykatën e Lartë njerëz jashtë sistemit apo do të na duhet një gjykatë karriere? Pse të mos e diskutojmë së bashku?

Për më tepër edhe Komisioni i Venecias në mënyrë të përsëritur ta ka thënë që të gjitha këto janë pjesë e diskutimit të brendshëm të ligjvënësit vendas, te pika 11, 14, 19, 23, 24, 38 dhe 61 e thotë në mënyrë të përsëritur. Për shembull te pika 61, thënë kjo te rreshti i fundit:

“Komisioni i Venecias përsërit që i takon ligjvënësist shqiptar të zgjedh një sistem të duhur për zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së dhe të gjyqtarëve të...”. Pra, ai të jep disa variante dhe midis këtyre varianteve na takon neve të zgjedhim. Hajde ta diskutojmë se çfarë na duhet të zgjedhim dhe kush është më e mira për ne. E gjithë kjo mënyrë sesi ju doni ta ndërtoni këtë gjë është që të anashkaloni këtë lloj debati që po afrohet në mënyrë konstruktive nga opozita. E bisedojmë, shohim se ku biem dakord dhe ku nuk biem dakord, e më pas u themi u themi ekspertëve të draftojnë cila është zgjidhja më optimale. Pse na e mohoni këtë lloj debati? Pse mos ta diskutojmë?

Unë besoj se i shërbejmë punës, që ta diskutojmë dhe të bëjmë një gjë për të qenë, në të kundërt janë të gjitha arsyet dhe indiciet që ne të mendojmë se synimi nuk është për të ofruar një reformë të qenësishme që t’i shërbejë këtij vendi, por pas gjithë kësaj historie fshihet qëllimi për ta kapur sistemin, për ta politizuar sistemin dhe për të bërë që sistemi të mos e godasë korrupsionin, i cili sigurisht që po zhvillohet në mënyrë galopante në këtë vend.

Ju ftoj edhe një herë të diskutojmë mbi problematikat që ne kemi nxjerrë dhe që na kanë ngelur pa zgjidhur. Siç jua përmendëm janë çështje dhe vërtet janë 10 “nukë”, por ju nuk keni pse të na vini përballë një “nuk” të madh, që nuk na i pranoni dhe nuk i diskutoni. Hajdeni t’i diskutojmë!

Faleminderit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Mua më duket se pavarësisht oponentëve që bëri zoti Halimi, që u duk, dhe ky është mendimi dhe perceptimi im, sikur ishte kundër qëndrimit dhe mjaft vlerësimeve që ka dhënë Komisioni i Venecias, por nga diskutimet e kolegëve të tjerë unë marr vesh ose kuptoj, ose më vjen mirë ta kuptoj, pasi nga 89-90 parashtrës që ka bërë Komisioni i Venecias, ne vijmë tek 10-11 çështje që nuk merren vesh ende. Kjo do të thotë se ne për 90% jemi marrë vesh dhe vijmë vërdallë për 10% dhe nga këto 10% jam optimist që ne do të merremi vesh. Çështja këtu është se te “flamuri”, të cilin në mënyrë figurative do ta quaja i reformës në drejtësi, që është ngulur në malin e Dajtit, ose do të shkojmë të tërë bashkë, ose nuk do të shkojë asnjë. Ne duke tërhequr nga këmbët njëri-tjetrin nga mbrapa jo unë, po ti, po pengojmë reformën. Pra, atë flamur duhet ta kapim të tërë bashkë me konsensus dhe nuk ka asnjë mënyrë tjetër dhe të tërë prerogativat dhe kushtet janë të tilla.

Natyrisht që LSI-ja është paraqitur edhe në Komisionin e Venecias me një draft vërejtjesh, jo për protagonizëm, por na vjen mirë që një pjesë e tyre janë pranuar, megjithatë mund të ketë mendime të kundërta dhe ne jemi të gatshëm që t'i diskutojmë, edhe tërhiqemi po qe nevoja në ndonjë mendim. Por, gjithsesi ne duhet patjetër të fillojmë dhe të vazhdojmë punën këtu në komision. E theksoj edhe një herë, që tryeza bazë e punës për të zhvilluar dialogun politik është Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

Natyrisht, ne nuk përjashtojmë as nevojën e tryezave të nivelit të lartë politik, fjala vjen të drejtuesve të nivelit të lartë politik, i mirëpresim, madje unë do të mbështesja çdo iniciativë të marrë nga kushdo, qoftë nga zoti Basha, qoftë nga zoti Rama, qoftë nga zoti Mediu, qoftë nga zoti Meta, që kjo tavolinë e nivelit të lartë të bëhet edhe kjo pjesë e këtij procesi. Pavarësisht se ku do të zhvillohet debati apo dialogu politik ne mendojmë dhe sugjerojmë që të ndjekim këtë metodologji.

Si fillim, të tëra forcat politike parlamentare të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre për çdo çështje të reformës në drejtësi. Një sekretari teknike duhet t'i rendisë të gjitha çështjet dhe zgjidhjet përkatëse të partive në një matricë. Kjo matricë të vazhdojë, duke gjykuar që në vijim të bisedohet me ekspertët e huaj dhe vendas, mund të organizohen tryeza bisedimesh të niveleve të ndryshme për çështje që ne nuk biem dakord. Siç e thashë edhe më parë, janë 10 çështje dhe unë jam optimist që këto çështje janë plotësisht të zgjidhshme.

Për sa i takon metodologjisë, zoti Xhafaj, këtu nuk dua ta përsëris edhe një herë konsideratën dhe vlerësimin tim për punën e ekspertëve, sepse kjo nuk diskutohet, aq më tepër edhe kontributin tuaj, them që në parim duhet të miratojmë ndryshimet kushtetuese. Pra, qëllimi është që t'i hapim rrugë hartimit dhe miratimit të afro 40 ligjeve të tjera, që në sesionin e vjeshtës të kapim axhendën e Komisionit European, për të marrë pjesë në negociatat për anëtarësim. Prandaj miratimi me konsensus i kësaj axhende, procesi i dialogut ka një valencë të jashtëzakonshme, posaçërisht për axhendën e Komisionit European. Ndoshta brenda 2 ditëve partitë parlamentare parashtrojnë çështjet e tyre, sekretaria teknike të përgatisë matricat, komisioni të fillojë shqyrtimin e çështjeve që paraprakisht janë të dakordësuara.

Pra, 79 çështje, në mos gaboj, janë të dakordësuara dhe na mbeten 10-11 çështje. Edhe vetë përfaqësuesit e opozitës janë të gëzuar, sepse gjykojnë që kemi fituar terren, sepse vërejtjet tona janë marrë parasysh nga Komisioni i Venecias, por për mua kjo nuk ka rëndësi fare. Shumë

mirë që kanë fituar çështjet tuaja, por e rëndësishme është që kemi fituar të tërë dhe nuk ka rëndësi për protagonizëm partiak.

Ekspertët të rihartojnë dispozitat që janë dakordësuar, duke shtuar edhe sugjerimet e Komisionit të Venecias. Pas përfundimit të këtij dialogu kërkohet një periudhë prej 3-4 ditësh për t'i dakordësuar, sipas këtij projekcioni që ne gjykojmë dhe nevojiten rreth 20-25 ditë në përfundim të këtij dialogu për këto çështje pak të dakordësuara dhe të padokërdusura që duhet të shoqërohen detyrimisht me vullnet pozitiv për të kapur afatet e domosdoshme.

Lidhur me këto qëndrimet e tjera të veçanta LSI-ja është shprehur që ne jemi vetëm për një Gjykatë të Lartë, sepse e argumentojmë këtë lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore. Nuk po zgjatëm për arsye të tjera, pasi ky është qëllimi kryesor. Ne duhet të kemi një Gjykatë të Lartë, me seksione të veçanta penale, civile, administrative dhe të tjerat vijnë më pas. A është kjo që ne themi fjala e fundit? Ta diskutojmë, mund të merremi vesh dhe ka vend për të vendosur. Jemi për një rivlerësim të rolit të Ministrit të Drejtësisë, jo se ministri është sot ky që është, por nesër mund të jetë një tjetër dhe është e domosdoshme që Ministri i Drejtësisë dhe pozicioni i tij, duke u parë dhe fakti që ai nuk është anëtar i asnjë organi që emëron, shkarkon apo promovon gjykatës apo prokurorë, por është zyrtari që në emër të publikut kryen procedimin disiplinor dhe paraqet masat përkatëse në KLGJ dhe në KLP. Prandaj, kemi mendimin se duhet parë që parimi i balancës së pushteteve duhet ridizenjuar dhe të bëhet më efektiv.

Personalisht lidhur me rekrutimin profesional dhe të karrierës në gjyqësor dhe në prokurori, mbështesim atë ide që kemi thënë se prokurorët dhe gjyqtarët duhet të emërohen pasi të kenë kryer Shkollën e Magjistraturës, por jo vetëm kaq, sepse analoge me Shkollën e Magjistraturës ne kemi mjaft nivele të tjera të arsimit juridik jashtë shtetit, të cilat janë analoge apo janë të një niveli. Ne nuk mund t'i përjashtojmë ata që kanë mbaruar shkollat e drejtësisë në Francë, në Itali apo në Angli në kohën që u azhornojmë diplomat t'u themi që nuk keni të drejtë të emëroheni. Pa dyshim edhe ata kanë të drejtë, pasi janë një kontingjent i rëndësishëm, mjaft kualitativ, të cilëve nuk duhet t'u mbyllim dyert.

Kam edhe çështje të tjera, por nuk dua të zgjatëm. Dua të theksoj, se jemi për një rishikim të thellë të rolit të prokurorisë. Ne jemi dhe qëndrojmë te parimi për një prokurori të fortë, me kompetencë, me përgjegjësi të plota në hetimin dhe ndjekjen penale. Nuk e mbështesim idenë e një prokurorie të vetëdecentralizuar, por mbështesim idenë e një prokurorie të profilizuar, e cila duhet të shmangë patjetër ping-pongun ndërmjet prokurorisë dhe policisë. Ne jemi për

krijimin Agjencisë Kombëtare të Hetimit, por të shkëputur nga policia me idenë që kjo agjenci të drejtohet ndoshta nga një bord shtetëror me përfaqësues të ministrave të fushës përkatëse, të Prokurorisë së Përgjithshme e të tjera, por jemi kundër Byrosë Kombëtare të Hetimit siç është konceptuar deri tani. Këto ishin disa nga mendimet. Edhe një herë, unë bëj thirrje për konsensus!

Zoti Halimi, do të më falësh që të përmenda emrin, por idenë e kam që për atë flamur do të vemë bashkë, veç e veç nuk vemi dot. Ti do të ikësh përpara, por unë do të tërheq nga këmbët, ose iki unë, më tërheq ti, sepse kështu nuk shkojmë dot.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë besoj vërtet se atë flamur në majë të Dajtit duhet ta vëmë bashkë, por nuk është vetëm rasti kur tërheqim njëri-tjetrin nga këmbët që të ngjitemi bashkë, por është edhe kur dikush zë rrugën dhe nuk lë asnjë tjetër të vejë sipër dhe, për fat të keq, kështu ka ndodhur.

Ajo që më shqetëson mua, gjithashtu, është një vërejtje që e kemi bërë edhe herën e fundit që jemi mbledhur së bashku: procesi i reformës në drejtësi, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, momenti është shumë i rëndësishëm, të gjithë e duam, ka superuar një vit humbje kohe dhe këtë e them me bindje. Por, për fat të keq, ajo që unë konstatoj që nga dhjetori, kur erdhi raporti *interim* i Komisionit të Venecias dhe na vuri më së fundmi në të njëjtën pikënisje, edhe pse ju si maxhorancë tentuat të niseshit me vrap kur patë që ne ishim dakord për të hyrë në proces, konsumuat muajt e vjeshtës me revanin tuaj, në dhjetor ne erdhëm në një pikë. Çfarë ndodhi në dhjetor? Janë tre muajt të tjerë të humbur.

Unë jam i bindur se të dyja palët kemi ekspertizë shumë të mirë dhe akoma më e mirë mund të bëhet puna e ekspertëve tanë nëpërmjet ekspertizës ndërkombëtare, akoma më e sigurt është kjo punë që bëjnë ekspertët nëse e gjithë nuk është çështje kompromisesh politike, por që do të ishin kompromise konsensusi politike të bazuara në standardet ndërkombëtare, në mënyrë specifike të Komisionit të Venecias. Ai është garancia, është tabani me të cilin nuk mund të shkohet poshtë. Unë besoj se këtë askush nuk mundet të vërë pikëpyetje.

Por, si i thonë një fjale, ju të maxhorancës diku gabuat dhe shtegu ju çoi poshtë dhe, për fat të keq, edhe ekspertët tuaj. Ekspertiza më e mirë e vënë në hullinë e gabuar procedurale dhe të objektivave të gabuar nuk mund të bëjë gjë tjetër, veçse të vijmë në një situatë të tillë, që detyrohemi të lexojmë dy raporte të Komisionit të Venecias. Pse them dy raporte? E them, sepse dua të zhbëj çdo iluzion, sepse mundet të lexohen pjesërisht çfarë është thënë drejt në këtë pikë,

siç e thotë edhe vetë Komisioni i Venecias, e ka trajtuar në mënyrë selektive një numër çështjesh, por çka thënë më përpara, nuk i ka ndryshuar. Kështu që ne do ta lexojmë gjithë kontekstin e çështjes, nuk janë vetëm 1 ose 2 çështje që nuk biem dakord.

Mazhoranca është përpjekur në mënyrë këmbëngulëse ta projektojë qëndrimin e opozitës, sikur ne kemi vetëm çështjen e 3/5-ve dhe 2/3-ve. Absolutisht, është infantile në rastin më të mirë, është keqdashëse në rastin më të keq, tinëzare madje. Pse? Sepse ne ia kemi bërë të qartë dhe nuk është ashtu siç thotë kolegu Majko se që nga hera e parë nuk i kemi bërë publike pozicionet tona.

I gjithë ky proces ka shkuar në rrugën e gabuar, ndaj produkti sot ka këto lloj vërejtjesh, sepse procesi i konceptuar nga ju si maxhorancë me qëllim të thjeshtë, që të shkonit me një sulm të fuqishëm drejtpërdrejt te rezultati, për të bërë më pas një tur force, se është yni dhe nuk mund ta bëni ju, ka sjellë këtë proces. Por, me sa duket, ju mbaroi bateria dhe Komisioni i Venecia jua thotë fare qartë: dialogu politik, sepse kjo është shumë e thjeshtë. Në fund fare, përtej asaj që një pjesë e mirë jona mund të jenë edhe jurist, ne jemi të gjithë përfaqësues politikë, që kemi përgjegjësi të jashtëzakonshme, jemi me investiturë përfaqësimi, që do të na duhet të ngremë dorën dhe të mbajmë përgjegjësi tani dhe për 10, 15, 20, 30 vjetët e ardhshëm për atë që do t'u japim shqiptarëve në Kushtetutë. Kështu që, kjo përpjekje për ta bërë në këtë formë, të nderuar kolegë të maxhorancës, nuk po bën gjë tjetër, veçse po e kris procesin aq keq, sa që mund të jetë edhe e pamundur ta rikuperojmë. Kështu që, i bëj thirrje ndërgjegjes suaj politike, që të kthehemi tek ajo që kemi thënë në datën 24 dhjetor, e konfirmuar në një rezolutë të parlamentit shqiptar të vitit 2014: “Të dyja palët angazhohen solemnisht me mbështetjen e Parlamentit Europian, që do të kërkojnë konsensus për çdo çështje, sa herë kjo është e mundur”.

Ja ku jemi në këtë komision. Ne po themi se ka probleme të rënda, janë 10, 11 çështje, të cilat nuk janë ashtu siç thotë zoti Braho, fragmentohet në shumë paragrafë ajo që ne e kemi përmbledhur në 10, 11 çështje principale, parimore. Po nuk u zgjidhën ato, problemi është shumë i madh. Sigurisht zgjidhen, sepse ajo që thashë është se ne duhet të jemi në kërkim të konsensusit dhe ne këtë po ofrojmë: të diskutojmë dhe të gjejmë konsensusin politik principal, mbi bazën e standardeve të Komisionit të Venecias.

Ka probleme. Ka probleme, që pa zgjidhjen e tyre nuk mund të investohet vota politike sikur asgjë dhe këtë nuk po jua themi ne, e thotë Komisioni i Venecias, gjithashtu. Vazhdoni në

rrugën e gabuar dhe treni do të përplasët me murin, ktheheni në rrugën e duhur dhe do të arrijmë në stacionin që duam të gjithë.

Unë besoj se me gjithë punën e lavdërueshme që kanë bërë ekspertët, kjo punë me këtë procedurë ka ardhur te fundi dhe duhet një koncept tjetër. E theksoj edhe një herë, janë 10, 11 pika, ku ne kontestojmë thelbësisht zgjidhjet që janë ofruar.

Do të ndalem tek ajo që ne e konsiderojmë themelore në këtë çështje: sistemi dhe arkitektura që ju keni propozuar është shumë problematike. Është shumë problematike, edhe sikur ne të marrim të mirëqenë qëllimin se e gjithë kjo qenka për të luftuar korporativizmin dhe korrupsionin. Nëse ne supozojmë që sot të fillojmë një luftë kundër korrupsionit dhe në krye të 5 vjetëve e kryejmë këtë çështje, ajo që do t'i mbetet Kushtetutës shqiptare është një ngrehinë e tmerrshme institucionesh që, nuk bëjnë gjë tjetër, veçse përplasen me njëra-tjetrën brenda sistemit të drejtësisë.

Nëse me pak vëmendje do të bënim një analizë të arkitekturës kushtetuese, do të kishim një sistem drejtësie në përplasje të vazhdueshme të brendshme përballë një ekzekutivi të fuqishëm dhe një parlamenti, që nëse ekzekutivi e kontrollon, siç është situata e sotme, që e ka parlamentin në një vulosësh të thjeshtë, sistemi i drejtësisë nuk do të ishte në gjendje që të përballonte goditjen që do t'i jepte ekzekutivi. Pra, do të ishim tek ajo që kemi thënë gjithë kohës: kapja politike.

Nëse ne nuk e thjeshtojmë dhe nuk e bëjmë këtë sistem siç duhet, ne do t'u lëmë shqiptarëve një dramë në sistemin gjyqësor, e cila do të zgjatet me dhjetëra vjet. Për fat të mirë, Komisioni i Venecias ka dhënë notën 5 për këtë, e ka thënë kështu siç është dhe e pranojmë, por nuk është çështje jona. Zgjidheni ju më mirë, siç duhet, sistemin e balancave! Kështu që, edhe kjo na ka hapur shtegun që të ulemi të diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhje. Ka institucione që do të mbeten, janë zgjidhje të reja dhe shumë të mira, por ka edhe të tjera që nuk duhet të jenë. Këshilli i Emërimeve në drejtësi na kthehet një superpotencë brenda sistemit dhe, në fund fare, nëse njëra palë, ose tjetra në një moment të caktuar do të destabilizonte procesin e votimeve që kërkohet të ndërhyjë parlamenti, ajo që mbetet është një renditje, që e ka bërë një organ që ka vërejtje kaq thelbësore jo vetëm në mënyrën se si ngrihet, por edhe në mënyrën se si përbëhet.

Po cila është vlera e gjithë institucioneve të tjera? Për sistemin, e thashë. Po eci në dy-tri pika të tjera: ndërprisni mandatet kushtetuese. E ka thënë Komisioni i Venecias për Serbinë.

Është qartazi një mënyrë për të kapur në një dorë të vetme gjithë sistemin. Sado që të lodheni, kështu është.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zoti Braho, mund të mos jeni dakord me maxhorancën në këtë pikë, nuk po them gjë, por të vazhdoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zoti Braho, unë ju ndoqa me vëmendje dhe po përpiqem t'ju kthej përgjigje për të gjitha.

Kemi një situatë të paqartë, me kompetenca të paqarta në lidhje me prokurorinë. Kush heton, çfarë? Kemi prokurorë të përgjithshëm, që, në fund fare, nuk e kuptoj pse duhet të investohet parlamenti me shumicë të cilësuar, kur një strukturë tjetër do t'i bëjë të gjitha hetimet më të rëndësishme. Por, ne edhe sot, faktin që kemi një prokurori, e cila nuk dihet ku jep llogari, e kemi problem, jo më ta bëjmë më të komplikuar se kaq. Është problem? Të ulemi dhe të diskutojmë. Këtë po ofrojmë ne sot në mënyrën më konstruktive të mundshme. Po ju themi: hajdeni të gjejmë zgjidhje për të arritur në majën e malit të Dajtit dhe të vëmë atë flamur!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por nuk mund të ishte thjeshtim i sistemit fakti që nga 5 anëtarë u bë 1, u bë organ monokratik dhe sot ju thotë Komisioni i Venecias: “Shikojeni, sepse ka mundësi që e keni gabim idenë me 3/5-at, sepse duhet ta bëni, të paktën, herën e parë me 2/3-at”. Pse? Sepse kapet sistemi. Pse? Sepse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ndikim të madh mbi sistemin dhe kontrollohet nga ministri i Drejtësisë. “E keni gabim”, - thotë Komisioni i Venecias.

Ajo që ne ofrojmë është: të gjitha çështjet principiale, pa të cilat kjo reformë nuk mund të ecë më tej, të fillojnë të diskutohen në një hulli krejt tjetër, konsensualiteti politik në një debat të shëndetshëm politik këtu mes nesh, me transparencë dhe mbi bazë parimesh ndërkombëtare, që na jep Komisioni i Venecias me ekspertizë shumë të mirë ndërkombëtare, ta bëjmë këtë gjë siç duhet dhe të mos humbasim më kohë. Çdo ngulmim në rrugën e deritashme do t'i shtojë muaj e muaj e muaj të tjerë një reforme dhe ne këtë e duam. E duam, pse? Sepse një reformë në drejtësi, që do të na japë gjyqtarë dhe prokurorë të pakapur nga qeveria, do t'i japë mundësinë këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve, që ministrat e tyre të korruptuar t'i çojnë përpara drejtësisë.

Por, që të arrijmë te ky konkluzion shumë i dëshiruar, për ne si opozitë duhet që ju të tërhiqeni nga ky pozicion i paarsyeshëm, të ulemi dhe të diskutojmë, të gjejmë kompromis principal politik dhe teknik për të gjitha çështjet që diskutuam dhe nuk ka asnjë gjë të keqe. Nëse

refuzohet një ofertë e tillë për t'u ulur dhe për të diskutuar, do të thotë se nuk e duam këtë ofertë, por bie ndesh edhe me marrëveshjen e 24 dhjetorit. Të kërkohet kompromisi sa herë të jetë i mundur dhe po jua japim këtë mundësi!

Për ta mbyllur, mbani mend një shprehje. Nuk është imja, por do t'i jepej një drejtuesi të një prej institucioneve ndërkombëtare shumë të rëndësishëm, që merret me Shqipërinë, i OSBE ODIHR-it në vitin 2003, që thoshte: “Kujdes, maxhoranca buldozer është po aq e keqe, në mos më e keqe sesa minoranca buldozer”.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ky është një proces maratonë, ku të gjithë shprehen dakord, por mbetet i bllokuar. Të gjithë thonë nuk ka asnjë pengesë, të gjithë nxjerrin pengesa. Disa nxjerrin pengesa në heshtje, disa përpiqen të japin si pengesë pikat dhe shqetësimet e opozitës.

Zoti Majko numëroi këtu 10 shqetësime të opozitës. Një arsye për t'u ulur dhe për të diskutuar janë 10 shqetësimet, që mund të jenë që të gjitha kot, mund të jenë që të gjitha të qena. Madje, duke biseduar për ndonjërin prej tyre mund të na dalin edhe të tjera që nuk i dinim. Zoti Majko i numëroi këto si 10 arsye, që tregojnë 10 prova që opozita nuk e do reformën në drejtësi. E bëri me një pyetje retorike, por unë kështu e lexova, ky ishte nënteksti.

Kush nxjerr arsye si këto dhe kush na çon sërish të Venecia dhe më pas diskutojmë sërish për Venecian, ai nuk e do reformën për drejtësi. A është kjo shqetësuese? Unë mendoj se jo. Shqetësuese është qartësia e zotit Majko, që këto 10 shqetësime, nuk janë shqetësime.

Kryeministri thotë: “Jo, unë nuk merrem me këtë, sepse reforma duhet të jetë një produkt i virgjër politikisht, as nuk e kam lexuar reformën”, besoj të njëjtin qëndrim ka zoti Majko, zoti Xhafaj nuk shprehet, zonja Hysi thotë se i ka lexuar disa prej gjërave. A është çështje reforma? Po, apo jo? Është reforma? Po. Kemi thënë 140 vota të parlamentit, kështu nis reforma. Thamë po të gjithë, hajde të ulemi ta bëjmë. Dikush nuk e donte opozitën dhe tha: jo, e bëjmë vetëm.

Tani jemi te materiali. Pro, apo kundër materialit? Jua thanë kolegët, nëse që në fillim do të ishim ulur, do të kishim bërë me të vërtetë reformë dhe jo stërkëmbësia, nëse kjo tryezë do të kishte funksionuar, ndoshta do të kishim fituar 1 vit e gjysmë kohë më shumë dhe do të kishim çuar disa herë më pak te Venecia, do t'i kishim angazhuar disa herë më pak me punë ata burra të nderuar që na asistojnë dhe mbase do t'i kishim pyetur për dy-tri gjëra të vogla, çështje estetike dhe funksionaliteti, por jo për çështje parimi.

Keni zgjedhur ju, jo ne, rrugën më të gjatë, ta çoni vazhdimisht te Venecia, t'i kërkonit interpretim dhe interpretim të interpretimit të Venecias, që në fund fare të përfundojë me një interpretim tjetër të interpretimit më të fundit. Kjo është lojë kungulleshkash, sepse, së fundmi, në këtë 1 vit e gjysmë, me të gjithë respektin, apo disrespektin që secili prej nesh mund të ketë për punën, grupin dhe materialin e ekspertëve, fakti është fakt: Venecia e ka rrëzuar në të gjitha pikat. E ka rrëzuar vetëm në 50. A mbeten vetëm 10 shqetësime? Sikur vetëm 2 të mbeten në 100 pika, janë ato që mund të deformatojnë arkitekturën. ADN-ja, kodi i genomës, i shimpanzesë nga i njeriut, në 98% është identik, 2%-shi e ndan. Do të jetosh në xhungël, apo jeton në Tiranë, profesoreshë? Kjo është shumë e rëndësishme.

Zoti Majko thotë: jo, 10 pikat e opozitës janë 10 pika që tregojnë se opozita nuk e do reformën. Janë 10 shqetësime, mbi të cilat mund të marrim dhe të nxjerrim përgjegjësitë mbi gjënë, nuk është shumë e vështirë.

Kjo tryezë ka tre komponentë: PS-ja, LSI-ja dhe opozita. Diku këtu fle lepurit. Ne po themi: hajdeni të ulemi, të diskutojmë. Ju sërish refuzoni të diskutoni.

LSI-ja ju thotë: po, jemi besimplotë, në mos gaboj, e tha zoti Braho, te konsensusi, te dialogu dhe mund të arrijmë në një emërues të përbashkët dhe ju sërish vazhdoni të thoni jo.

Nëse e shikojmë në dritën e vërtetë të fakteve, këtu ka një pengues dhe unë besoj se del cili është. Ai që thotë: “Ne nuk kemi asnjë shqetësim, as nuk dua ta lexoj gjënë, do të pranoj me sy mbyllur çfarë thonë ekspertët, edhe po i ktheu sërish Venecia”. Kush e thotë këtë, zoti Pandi? Nuk është hera e parë që bën reformë ky vend.

Në këtë tryezë kemi burra shumë të nderuar që në gusht të vitit '97, filluan një reformim të drejtësisë. E kam thënë dhe do ta përsëris sërish. Më pas vazhduan po pa opozitën, bënë edhe një Kushtetutë, këtë që kemi sot, rregulluan KLD-në, rregulluan prokurorinë, e çrregulluan sërish dhe e rregulluan prapë, rregulluan gjykatat dhe më pas Gjykatën e Kasacionit e kthyen në Gjykatën e Lartë. Epo thamë: shumë rehat. Opozita nuk donte. Turp t'ju vijë!

Dalin tani zoti Pandi dhe zoti Fatmir, ish-kryeministri i kohës, dhe ish-ministri i Drejtësisë i kohës, ish-sekretar i Këshillit të Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave i kohës, anëtarë kabineti dhe na thotë: shikoni, kjo që kemi këtu është një mostër. Prisni, sepse ka nënë dhe babë kjo mostra që kemi ne këtu dhe e keni bërë pa opozitën. E keni bërë ju si qeveri me Komisionin e Venecias dhe sot dilni dhe na thoni: nuk bën.

Gabon njeriu një herë, dakord, gabim që kemi 20 vjet që e vuajmë. Po të gaboni edhe 20 vjet të tjera, na iku jeta, zoti Pandi. Shikoni të bëni dialog edhe me faktorë të tjerë, ose me aktorë të tjerë që nuk kanë bërë këto gabime si mostrat që kemi sot. Hajdeni ta diskutojmë. Ju thoni jo. Kurrë nuk ma merrte mendja se do të ishte Spartak Braho më pranë konsensusit dhe dëshirës për dialog dhe për të diskutuar gjërat.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Sigurisht në politikë, sepse ne jemi njerëz politikë. Në qoftë se gënjejnë dhe thonë se jemi ekspertë, jo. Secili prej nesh ka ekspertizën tonë, por jemi njerëz politikë dhe vota në parlament do të jetë politike, jo votë ekspertike. Përgjegjësitë që do të mbajmë, përgjegjësitë që kemi para opinionit publik janë përgjegjësi politike që, forca që sot e drejton këtë vend me shumë militantizëm, me shumë kokëfortësi, me shumë vendosmëri, i ka mbajtur në shumë momente udhëkryq të këtij vendi.

Më lejoni t'ju kujtoj tri ligjet. Ne thoshim: hajdeni të votojmë tri ligjet, këta thoshin jo, sepse ligjet këtu te ne nuk zbatohen. Si nuk zbatohen? Kemi 10 kërkesa dhe nuk i kishim teknike, i kishim politike. I kishim të gjitha kërkesa antikapje, të mos kapej shteti, të mos kapeshin institucionet. Cilat? Kërkesa fillonte me Këshillin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, Këshilli i Mediave Audiovizive, këshilli i qarkut të Fierit, në qoftë se e mbani mend, ishte një tmerr i madh. Ujësjellësin e Tepelenës nuk po e përmend. Tani këta zotërinj, të cilët kanë mbrojtur heroikisht në parlament, duke bllokuar seanca, këto pika, prioritete që ju thashë, për moskapjen nga qeveria, sot thonë jo.

Të gjithë ne kemi një detyrim ndaj njerëzve që na kanë votuar. Një drejtësi e drejtë është ajo që është e barazlartuar nga krahët politikë; një drejtësi e drejtë është ajo, që nuk e ka ndikimin e zgjatur të ekzekutivit. Opozita nuk ka krahë. Këtë detyrë kemi ne sot dhe jo të paketojmë gjëra, t'i vëmë edhe një pullë dhe t'ia çojmë Venecias. Ne jemi mbledhur këtu që të ushtrojmë përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë tonë politike. Duhet të mbajmë përgjegjësi për fjalët e bukura që u kemi thënë njerëzve në fushata. Nuk mund t'u themi ekspertëve, sado të

pikuar nga qielli të jenë: “Bëjeni ju dhe mbajeni ju përgjegjësinë përpara njerëzve!”. Jo, zotërinj dhe ju e dini fare mirë që nuk është kështu.

Qetësia juaj për shqetësimet e opozitës dhe për një komponent, jo pak të rëndësishëm të qeverisjes, për mua zbulon se cili nuk e do reformën. Zbulon që kjo që ne e quajmë reformë, nuk është reformë. Kurrë mos ndodhtë, në qoftë se nuk bëhet ashtu siç e duam ne! Bëmë një kuçedër me 7 koka në vitin '98. Dy kokat janë vjetruar, hajde t'ia ndërrojmë, të bëjmë një të re! Për këtë punë ne nuk na keni.

Përpara mediave shpesh themi se përgjegjësia është e të gjithëve, por këtu në tavolinë ka nga ata që duhet të kenë pak më shumë përgjegjësi për këtë drejtësi që kemi sot. Ata duhet të jenë edhe më të përgjegjshëm edhe sot kur flasim.

Shqetësimet e reformës janë shqetësimet e të pafuqishmëve të këtij vendi. Drejtësia funksionon dhe është e pavarur që të gjejnë drejtësi të pafuqishmit dhe jo të pushtetshmit. Të më gjejë ndokush ndonjë vend të botës, jashtë këtij rregulli e të më thotë se është drejtësi. Drejtësinë popullore të asaj që shkruhet me parulla e kemi pasur nga '44-a, deri në '89-'90-ën. Nuk e duam më. Duam një gjë tjetër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja - Faleminderit, kryetar!

Edhe unë dua të jap disa konsiderata lidhur me rendin e ditës, për të cilin jemi mbledhur sot.

Me thënë të drejtën kemi dy orë që i shkojmë rrotull një problemi me argumente të tipit e thamë, nuk e kemi thënë, e lagu nuk e lagu, për një proces kaq themelor që është reforma në drejtësi, e cila është një reformë për njerëzit e ndershëm dhe për gjyqtarët e prokurorët e ndershëm të këtij vendi,

Nga diskutimet që dëgjova deri tani m'u krijua përshtypja se procedura që është ndjekur deri tani, ka qenë humbje kohe shumë e madhe. Në gjykimin tim të tentosh të bësh ndryshime kaq të thella kushtetuese, për të rithemeluar një pushtet nga e para, siç është pushteti gjyqësor, dhe të thuash se është humbje kohe një vit, nuk më duket e drejtë.

Unë nuk e them këtë, sepse është procesi më serioz, që është bërë ndonjëherë për sa i përket ndërmarrjes së një reforme nga organi legjislativ. U krijua përshtypja që ekspertët e mbaruan detyrën, prodhuan një draft, i cili shkoi në Venecia herën e parë, u ripunua herën e dytë

shkoi përsëri dhe erdhi. Tani sot në këtë tryezë na thuhet: “Jo, faleminderit për punën që bëtë. Drafti juaj na shërbeu ne anëtarëve të Komisionit të Reformës në Drejtësi, që të iluminohe mi juridikisht, sepse kemi qenë në errësirë, por tani ju nuk na duheni më. Do të startojmë një proces alla shqiptare, nga e para të tipit, ulu dy palë, dy veta andej dhe dy këtej, mbyllu me një zyrë atje.” Jo, kështu nuk mund të shkohet në fundin e një procesi kaq të rëndësishëm, siç është reforma në drejtësi. Ne nuk kemi luksin të startojmë një proces nga e para, të nderuar kolegë të opozitës, sepse në këtë proces nuk jemi dy palë, por tri palë. Jemi ne si maxhorancë, jeni ju si opozitë, por janë edhe partnerët tanë, SHBA-ja dhe BE-ja që na kanë thënë jo më larg se disa ditësh Sekretari i shtetit amerikan në ditën për diell: “Në këtë proces jemi tri palë, sepse edhe ne jemi bashkautorë të hartimit të atij projekti që ka shkuar në Venecia”.

Tani si t’u themi ne këtyre? Nuk na duheni, sepse do ta bëjmë ne?! Ndërkohë që nga mëngjesi deri në darkë, thuhet opozita dhe maxhoranca janë dakord për reformën në drejtësi dhe si emërues të përbashkët do të kenë opinionin e Komisionit të Venecias. Deri këtu jemi në rregull.

Sot pse na thuhet që do të startojmë një proces nga e para? Nga 89 rekomandime, që ka bërë Venecia, na prezantohen nga opozita se nuk janë dakord me 11-ën. Jo, kjo nuk është e nderhme. Nuk janë 11, është tërësisht drafti. Tentohet të hidhet poshtë tërësisht projekt-drafti, opinionin final që ka sjellë Komisioni i Venecias.

I nderuar koleg, unë e lexoj draftin si jurist. Unë nuk merrem me kleçkat. Projekt-drafti i ndryshimeve kushtetuese, që ka ardhur ky material nga Venecia grupohen në tri grupe: janë masat antikorrupsion, struktura institucionale e organizimit dhe e funksionimit të sistemit të drejtësisë. Pra, pushtetit gjyqësor, sistemit të drejtësisë penale dhe procesi i pastërtisë. Këto janë tri shtyllat kryesore të këtij drafti bashkë me ato 11 vërejtje, për të cilat opozita thotë ne nuk biem dakord. Unë e përkthej, as më shumë e as më pak, që këtij drafti i thuhet: “Ti nuk na duhesh më, sepse ne do të fillojmë nga e para, sepse nuk jemi dakord as për masat antikorrupsion, as për strukturën institucionale dhe as për procesin e pastërtisë”.

Unë mendoj se ka vend për kompromis, që reforma të jetë gjithëpërfshirëse, sepse Kushtetuta nuk mund të ndryshohet pa ju, sepse duhen 94 vota. Ndaj duhet të jemi seriozë.

Zoti Mediu tha pak më parë se jemi në kushtet që të fillojë një diskutim i karakterit teknik. Ta ndajmë diskutimin politik me diskutimin teknik dhe profesional, por jo të ngremë

edhe një herë nga e para një tryezë të diskutimit teknik dhe profesional, sepse ja ku i kemi ekspertët, ja ku e kemi edhe emëruesin tonë të përbashkët, që është Venecia.

A ka pika për të cilat është rënë dakord dhe mund të biem dakord me Venecian? Po. T'i ndajmë, por jo t'i ndajmë ne politikisht në tryezë, sepse ne jemi politikanë, jemi deputetë. T'i ndajmë ekspertët e nivelit të lartë me ekspertët tanë, të PD-së, të PR-së, të PS-së, të LSI-së. Le të shkojnë atje ekspertët tanë, le të ulen me ekspertët e nivelit të lartë, sepse janë bashkëpronarë me këtë draft.

Zoti Halimi thotë jo, sepse do t'i përjashtojë këta si palë. Nuk i duhen më ata tani. Do ta bëjë si ajo reforma, që nuk dua t'ia përmend emrin, që u ndryshuar Kushtetuta me 4 nene, me 4 fletë formati dhe hajde të ndryshojmë nenin 45 të Kushtetutës. Ky është serioziteti i këtyre.

Që të jemi seriozë, të nderuar kolegë, unë e shikoj të mundshëm dakordësimin dhe afrimin e qëndrimeve tona për këtë reformë. Po ju them një gjë. Unë vij nga ai sistem, siç vijnë edhe disa kolegë të tjerë. Nuk e kemi ne monopolin dhe tagrin për të thënë se çfarë është e mirë për sistemin e drejtësisë në këtë vend dhe çfarë është e keqe, aq më tepër njerëz me ngarkesa politike, duke filluar nga i pari deri tek i fundit. Edhe ne kemi ato kusuret tona ndaj këtij sistemi.

Kjo maxhorancë nuk ka asnjë merak për ta kapur sistemin, të jeni të bindur. Një maxhorancë që kërkon të bëjë një prokurori antikorrutive, si zyrë të pavarur hetimore në varësi të së cilës do të ketë edhe ajo struktura të posaçme hetimore, që për hir të së vërtetës, në draftin e parë që kemi çuar në Venecia e kemi parashikuar në varësi të kësaj strukture, nuk besoj se ka tendencë të kapë sistemin e drejtësisë, sepse po të ishte kështu, ne nuk do të ishim ata që do të ngulnim këmbë, nga fillimi deri në fund, krijimin e kësaj strukture, që në fund të fundit jo vetëm që do të pastrojë drejtësinë nga të korruptuarit, por pse jo ta bëjë politikën edhe më të pastër.

Ne politikanët duhet të themi: po, duhet reforma në sistemin e drejtësisë, sepse edhe në politikë kemi një problem duke mosfunksionuar drejtësia.

Urdhëroni, hajdeni ta marrim me seriozitet këtë problem! Bazën ja ku e kemi, se vetë kemi rënë dakord, por mund të mos biem dakord për një, dy, tri, gjëra, hajde t'i diskutojmë.

Grupi i ekspertëve është ngritur në zbatim të një vendimi të Kuvendit të Shqipërisë dhe po çlirohemi për një moment nga ngarkesat politike që kemi. Unë jam i bindur se fundi i marsit do të na kapë me ndryshimet kushtetuese të miratuara dhe në hapjen e rrugës, siç tha kolegu

Braho, për të punuar edhe me 40 ligjet e tjera, për të arritur ato afate që duhet të arrijmë. Këtu duhet sinqeritet, pastërti dhe vullnet për t'u shkuar gjërave deri në fund.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fatmir Mediu – Me gjithë respektin që kam për kolegët, dua të theksoj edhe një herë, se duhet ta dëgjojmë njëri-tjetrin. Po e përsëris: ekspertët e opozitës dhe opozita i kanë përcjellë Komisionit të Venecias vërejtjet e tyre për draftin që ju i keni paraqitur Komisionit të Venecias. Në atë kohë kërkuam që të kishim një draft konsensual. Nuk u ra dakord. LSI-ja dhe opozita paraqitën vërejtjet.

Nga të gjitha vërejtjet që ka bërë opozita, për të cilat shpresoja se do të kishit mirësinë që t'i kishit lexuar përpara se të arrinit në përfundim vetëm me dëgjimin e sotëm, një pjesë e tyre janë marrë në konsideratë. Po ju përmend dy nga ato 11, që janë marrë në konsideratë: Byroja Kombëtare e Hetimit, mosndërprerja e mandatit të institucioneve kushtetuese. Pra, në këtë pikëpamje, unë mendoj se duhet të kemi vullnetin për ta kuptuar dhe dëgjuar njëri-tjetrin. Pra, nuk po kërkojmë as më shumë as më pak, por këto pretendime të ngritura, këto vërejtje të sugjeruara, ku një pjesë e tyre janë konsideruar nga Komisioni i Venecias, t'i marrim një nga një, për të arritur në përfundimin se ku jemi dakord dhe ku jo.

Çështjet, në qoftë se janë politike, do të zgjidhen politikisht, sepse kanë nevojë për mirëkuptim politik; çështjet të cilat nuk janë të nivelit politik, por duan pa dyshim një trajtim më teknik, përfaqësuesit të ngrihen në konsultim me kë të munden, në të gjithë sferën e jurisprudencës që ka Shqipëria, të dalë në përfundime që duhen edhe me mbështetjen e SHBA-së dhe BE-së, në mënyrë që të arrijmë atë çka duam të gjithë, reformën në drejtësi.

Pra, nuk është mirë që ne të themi që ju këtu sot na sollët 11 pika që hidhen poshtë. Jo, zotërinj, këto 11 pika janë vlerësuar nga Komisioni i Venecias dhe nuk mbeti që t'i përjashtojmë apriori. Janë vlerësuar, po ju them janë vërejtje me shkrim që ne i kemi nisur Komisionit të Venecias.

Prandaj është mirë ta dëgjojmë njëri-tjetrin. Nuk e përjashtuam draftin tuaj. Ne mbi draftin tuaj bëmë disa vlerësime dhe vërejtjet tona. Komisioni i Venecias pa edhe draftin që paraqitët ju, pa edhe vërejtjet tona dhe ka sjellë një draft rekomandimesh. Një pjesë e tyre janë vlerësuar, një pjesë mbetet t'i gjykojmë me njëri-tjetrin. Kjo është e gjitha.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Pasi folën të gjithë anëtarët e komisionit, dua të jap disa konsiderata më të shkurtra se ato të fillimit.

E para, ne e kemi filluar bashkë procesin në muajin korrik, por qëndrimi ynë ka qenë tërësisht racional. Ne ju thamë në korrik dhe në gusht hajde të bëjmë një draft të përbashkët të ndryshimeve kushtetuese si bazë për reformën në drejtësi, sepse reforma në drejtësi është një paketë e plotë me 40 apo me 50 ligje. Ta shkruajmë bashkë me dialog politik. Këtu kemi qenë në këtë sallë. Të gjithë ju u ngritët dhe thatë: “Jo, do ta bëjmë vetë, nuk ju presim”.

Madje doli edhe Kryeministri dhe tha: “Unë i kam hipur trenit. Po të doni hajdeni, po të doni mos hajdeni!” Është kështu, apo jo? Njësoj siç bëtë me Byronë. Edhe me Byronë kështu bëtë. Ju thamë atëherë: “Prisni ta bëjmë bashkë Byronë, sepse është thembra e procesit të luftës kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë”.

Duam ta luftojmë korrupsionin e zyrtarëve të lartë? Cili është instrumenti? Byroja. E bëtë vetë. Proces i njëanshëm. Ngritëm 50 çështje. Erdhëm në dhjetor. Venecia, në mos gaboj, nga 138 paragrafë, ktheu rreth 50 paragrafë. I kërkoi qeverisë t’i ndryshonte.

Çfarë ju thamë ne? Hajde të ulemi sërish për dialog. Nuk kishte pse të vinim për herë të dytë. Për procesin e dekriminalizimit nuk shkuam. Pse? Sepse ramë dakord. Mund të binim dakord që në muajin shtator. Ju thatë, nuk na duhet dialogu. Ju ecët vetë. E bëjmë vetë, thatë.

Erdhëm përsëri në dhjetor. Ishim përsëri në këtë sallë. Ju thamë: “Hajde ta shkruajmë përsëri”. Të ulen bashkë ekspertët dhe të shkruajnë draftin. Të zgjidhim çështjet politike që i kishim që në shtator. Hajde t’i zgjidhim! Jo, thatë, do të ecim vetë! Po deshët hajdeni, po nuk deshët, ne do të ikim vetë! Humbën edhe tre muaj të tjerë.

Erdhëm sërish në mars. Çfarë kërkon sot opozita? Opozita thotë se sot janë 11 çështje, për të cilat ju ftojmë të dialogojmë.

Këto 11 çështje dhe këtë dialog e kërkon Komisioni i Venecias dhe jo opozita. Unë jam njeri skrupuloz. Unë i lexoj. I marr shumë seriozisht çështjet dhe i lexoj me shume skrupulozitet. Në paragrafin 23 të opinionit të Komisionit të Venecias thuhet: “Kjo është një çështje më shumë politike sesa ligjore”. Kjo thuhet për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë. Ju thoni: Jo, të mos hyjmë fare në këto çështje, sepse po thatë këtë gjë, atëherë jeni kundër reformës. Unë po them se këtë e thotë Komisioni i Venecias. Venecia kërkon 7 herë dialog politik; kërkon dialog për çështjen e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm, kërkon

dialog politik në paragrafin e 61-të për mënyrën se si do të kontrollohen gjyqtarët dhe prokurorët, që u tha këtu. Për këtë çështje Komisioni i Venecias thotë: “Duhet dialog politik”. Nuk është se e shpik. E kishim kërkuar ne që në muajin shtator. Na dhanë të drejtë në muajin dhjetor. Ju nuk na dhatë të drejtë dhe e ngritëm përsëri, dhe për këtë çështje thuhet: “Duhet dialog politik”. Thënë kjo, Komisioni i Venecias përsërit se i takon ligjvënësit shqiptar të zgjedhë një sistem të duhur për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të kualifikimit.

Por çfarë thotë Komisioni i Venecias për strukturën, që ju u mërzhitët kaq shumë? Sipas Komisionit të Venecias në paragrafin e 11-të thuhet: “Ka një argument të fortë për ekzistencën e këtyre institucioneve, por në përfundim i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë një sistem të kontrolleve dhe të ekuilibrave”. Kujt i takon? Çfarë thotë Komisioni i Venecia? Dialog.

Çfarë thuhet në paragrafin e 23-të të Komisionit të Venecias, kur flitet për zgjedhjen e anëtarëve? Thuhet: Dialog.

Çfarë po kërkon opozita? Dialog.

Çfarë tha opozita ditën kur erdhi raporti? Doli me triumfalizëm? Jo. Unë dola dhe thashë: “Venecia është shtrati ku duhet të ecim”. Pra, cili është shtrati ku duhet të ecim? Dialogu. Për sa çështje? “Për 11 çështje”, thotë opozita. “Për 7 herë”, thotë Komisioni i Venecias. Zoti Braho ngre 8 çështje, i cili m’u duk racional.

Zoti Braho thotë: kam 8 çështje, të cilat mendoj se kanë nevojë për dialog politik, nga 89 paragrafë që janë, sepse një pjesë e tyre janë çështje teknike, por që në mënyrë të padiskutueshme problemet politike duhen zgjidhur, të cilat sot nuk i themi më. I kemi thënë në muajin shtator, edhe atëherë na paragjykonit. I kemi thënë edhe në dhjetor, por edhe atëherë na paragjykonit, por sot i thotë Komisioni i Venecias, paragrafë më paragrafë.

Po jua lexoj edhe një herë paragrafët: 11, 14, 19, 23, 24, 38, 61 ku thuhet: “Duhet dialog politik”. Ne po kërkojmë që këto çështje të vijnë në tryezën e dialogut politik.

Kush është pro Komisionit të Venecias këtu? Jemi ne, sepse po kërkojmë dialog politik. Ju thatë, në mënyrë absolute u shpreh zoti Majko: “Asnjëra nga këto nuk mund të pranohet, sepse po t’i rreshtojmë të gjitha këto 10, atëherë ne i biem në ballë reformës në drejtësi”. Kjo është çështje e përmbajtjes së draftit, e ndryshimeve kushtetuese, për të cilat ne po kërkojmë dialog politik, të cilin e kërkon Komisioni i Venecias. Dialogu politik çon në konsensus politik, në mënyrë racionale, me një metodologji, siç u shpreh ndoshta zoti Braho, siç u shprehën kolegë të tjerë. Pra, një dialog politik është i nevojshëm, që të mos rrimë edhe 6 muaj të tjerë, sepse

kemi ndenjtur 9 muaj që nga korriku deri më sot vetëm për shkak se ju keni refuzuar dialogun politik.

Si e kërkonti konsensusin kur refuzoni dialogun politik? Ne kërkojmë dialog politik bazuar në draftin e Venecias. Ju thoni: “Na jepni konsensusin, por harrojeni dialogun politik”. Ju e dini shumë mirë që konsensusi arrihet në bazë të dialogut politik. Pa folur pastaj për besimin mes palëve, sepse këtu kemi qenë. Ne, palët politike, të mos bëjmë kot hipokrizi, sepse të qëndrosh pas fytyrës së ekspertëve është hipokrizi dhe ajo na ka çuar në pikën ku jemi sot, 9 muaj me vonesë për paketën e ndryshimeve kushtetuese. Hipokrizia na ka çuar në pikën, që ka dy vjet dhe nuk miratohet Byroja Kombëtare e Hetimit, vetëm hipokrizia dhe asgjë tjetër.

Prandaj, ka nevojë për një dialog të sinqertë, siç thotë Komisioni i Venecias vetëm për çështjet që kërkon Venecia, 11 ne, 8 zoti Braho dhe nuk e di nëse ka të tjerë. Ky është procesi. Kërkesa e opozitës është racionale, për të rakorduar më shpejtë reformën, për të mos u kthyer te hipokrizia. Ky është proces që duhet të bazohet në një dialog të sinqertë, sepse këtu kemi qenë. A ishim ne që bashkë votuam ligjin “Për nëpunësin civil”? Sa erdhët ju në pushtet, e ndryshuat me akt normativ, që ishte i pari akt që bëtë. Kështu, e vratë ju konsensusin. Tani kërkonti konsensus, edhe pa dialog. Ju e vratë brenda një nate. A ishte kështu apo jo, më 30 shtator të vitit 2013, sapo erdhët në pushtet, e vratë? A miratuam ne bashkërisht ligjin “Për Gjykatën e Lartë”, me konsensus bashkë me LSI-në? A ndodhi kështu? A e ndryshuat sa erdhët në pushtet? A e vratë konsensusin? A miratuam ne ligjin “Për gjykatat administrative”, me konsulencën e USAID-it? A i miratuam bashkë të gjitha? Sa e morët pushtetin, i ndryshuat.

Prandaj, ne kemi të drejtë të jemi skeptikë, sepse ju nuk u keni qëndruar asnjëherë marrëveshjeve, por kjo është çështje tjetër. Çështja e tanishme, janë këto 3 pika, të cilat i ngre Komisioni i Venecias dhe për të cilat kërkon dialog. Kush refuzon dialogun, është kundër shtratit ku duhet të ecim. Ne duhet të ecim vetëm në këtë shtrat, që është drafti i Komisionit të Venecias, i cili kërkon dialog politik për zgjidhjen e çështjes. Pasi të mbylлим dialogun politik, të ulen ekspertët e PS-së dhe të PD-së nën mbikëqyrjen dhe monitorimin e dy ekspertëve të nderuar, gjyqtarit Deville dhe prokurorit Smibert dhe të hartojnë të gjitha çështjet për të cilat ne jemi dakord.

Ky është një propozim racional. Prandaj, ju kërkoj me shumë racionalitet, të mos bëni të njëjtën gjë që keni bërë 2 herët e kaluara, për ta injoruar konsensusin dhe për të mohuar dialogun, sepse këtë herë jua kërkon Komisioni i Venecias.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, në mbyllje të këtij debati, dua të shpreh edhe unë gjykimet e mia.

Ne jemi në një moment shumë të rëndësishëm. Dikush mund ta quajë larg, dikush mund ta quajë afër. Nuk kanë rëndësi ditët apo koha që do të na duhet për ta përmbyllur, por jemi në një moment shumë të rëndësishëm, në momentin e finalizimit të projektit kushtetues, që do të thotë: jemi në momentin e finalizimit të hapit vendimtar për reformën në drejtësi, që është bazamenti i të gjithë reformë në sistem, që do të shoqërohet me një sërë nismash të tjera ligjore.

Sot nuk është dita për të thënë se kush e dëshiron reformën dhe kush jo. Kjo reformë nuk ka filluar sot, por ka filluar në nëntor të vitit 2014. Tani jemi në muajin mars të vitit 2016. Se çfarë ka ndodhur nga nëntori i vitit 2014; në verën e vitit 2015, në muajit korrik-gusht, kur u bashkua edhe opozita me ne apo sot, në vitin 2016, kjo është diçka që të gjithë e dinë tashmë. Sot kemi rënë dakord, në mënyrë të veçantë gjatë gjithë këtyre muajve, të pranojmë dy elemente të rëndësishme, që do ta çonin përpara këtë proces:

Së pari, asistencën ndërkombëtare, të fokusuar në mënyrë të veçantë te EURALIUS-i dhe tek OPDAT-i. E kemi pranuar dhe e kemi përshëndetur këtë gjë, me sinjeritet apo me hipokrizi, kjo është një çështje që nuk e ndajmë dot tani dhe nuk kemi pse ta ndajmë. E kemi pranuar. Formalisht ose në aparence, nuk kam dëgjuar njeri ta kundërshtojë, përkundrazi të gjithë e kanë konsideruar element të garantimit të procesit. Pikërisht, ekspertizën e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it e kemi pjesë të ekspertizës që ka hartuar këtë projekt kushtetues për të cilin po diskutojmë në mënyra nga më të ndryshmet. Kanë dalë edhe partnerët ndërkombëtarë përmes përfaqësuesve të tyre këtu dhe me përfaqësuesit më të lartë ndërkombëtarë, që kanë vizituar këtë vend, sekretari amerikan i shtetit dhe komisionerja e BE-së, të cilët kanë deklaruar se ky është një projekt ku ne jemi hartues, jemi bashkëpronarë, që është një produkt i përbashkët. Pra, kemi një projekt kushtetues të përbashkët.

Por, pse këta ekspertë vendas? Nuk dëshiroj fare t'i hyj këtij diskutimi sot. Do ta bëja me qejf. Me shumë dëshirë, në respekt edhe të sakrificës, të angazhimit, të përgjegjësisë, të profesionalizmit të treguar prej tyre, si dhe nga sekretariati teknik që ka punuar për ta. Do ta bëjë me shumë dëshirë, por nuk është ky momenti për një gjë të tillë. Kjo ka qenë metodologji e vendosur që në nisje të këtij procesi. Ju nuk ishit, por ky nuk është faji ynë. Kjo metodologji i ka

rrënjët në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, i cili që kur e ka nisur këtë proces, e ka nisur në bazë të këtij koncepti, mbi këtë qasje. Është ekspertiza ajo që do të ndërtojë projektin dhe është politika ajo që do ta gjykojë projektin. Kjo është qasja, ndryshe nga herët e tjera.

Një qasje tjetër mund të ishte që qeveria ta hartonte edhe politika, pra ligjvënësit ta gjykonin. Kuvendi, pra ligjvënësit, për arsye të njohura, dolën në përfundim që këtë të mos e hartojë qeveria, por ta hartojë një grup ekspertësh, vendas dhe ndërkombëtarë, që kanë si element garantues ekspertizën ndërkombëtare. Kështu vendosi legjislatori. Ky ishte vullneti i Kuvendit. Në vendimin e Kuvendit është thënë e zeza në të bardhë kështu siç po e them unë tani. Pra, do të thotë që i gjithë diskutimi do të bëhet në bazë të projektit të ndërtuar nga ekspertiza. Ky është vendimi dhe relacioni i Kuvendit. Ju nuk keni qenë në këtë proces.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju dëgjova kur folët. Është mungesë respekti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e hijshme për ju, por vazhdoni, nuk e kam problem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, e them edhe një herë për ata që kuptojnë dhe për ata që nuk kuptojnë, ose që nuk duan të kuptojnë. Ka dy mënyra për të gjykuar një parlament në bazë të një produkti qeveritar ose të një nisme deputetësh. Iniciativa mund të jetë një proces i brendshëm i parlamentit apo një proces i induktuar nga ekzekutivi.

Kuvendi vendosi të zgjedhë variantin e parë, duke thënë: ky do të jetë një proces i brendshëm i parlamentit. Parlamenti gjykoi. Kuvendi gjykoi dhe vendosi që ky proces të ndërtohet me këtë metodologji: ekspertiza dhe mbi ekspertizën është komisioni parlamentar.

A ka punuar mirë, apo jo ekspertiza, mund të thoshit çfarë të dëshironit, por mua më pëlqen t'i referohem "arbitrit", që quani dhe konsideroni ju, ai që është "arbitri" dhe rreth të cilit përulemi të gjithë. Ja çfarë thotë arbitri në pikën 86 të projektit të Komisionit të Venecias (dhe meqenëse jam këtu, në respekt të të gjithë atyre që duan të flasin këtu në këtë komision, këto nuk janë 89 çështje, por janë 89 pika, që për metodologji pune, Komisioni i Venecias nuk i ka çështje ligjore), pra, në pikën 86 thuhet: "Komisioni i Venecias përgëzon autoritetet shqiptare, sidomos ekspertët e komisionit parlamentar *ad-hoc*, për punën e bërë në përgatitjen e reformës kushtetuese të gjyqësorit. Kadishmëria e tyre për të marrë parasysh rekomandimet e opinionit të ndërmjetëm meriton vlerësim të veçantë". Gjithashtu, vlerëson edhe kontributin e ekspertëve të

dy grupeve politike: Partisë Demokratike dhe LSI-së, që kanë marrë pjesë aktive në diskutimin e projektndryshimeve kushtetuese dhe konteksti është fare i qartë: “Ka qenë një projekt ku janë përfshirë të gjitha palët me ekspertizë. Ne e vlerësojmë jashtëzakonisht grupin e ekspertëve”. Në fund fare, në pikën 87 Komisioni i Venecias në konkluzione, thotë: “Projektndryshimet kushtetuese përmbajnë propozime të qëndrueshme për strukturën e ardhshme institucionale të gjyqësorit”.

Teksti i projektit në tërësi është koherent dhe në përputhje me standardet europiane. Komisioni i Venecias beson se projektndryshimi mund të finalizohet pa vonesë dhe t’i paraqitet për votim parlamentit. Pra, ju e pranoni, dhe ne të gjithë e pranojmë rolin e Komisionit të Venecias. Ne kemi pranuar rolin e ekspertëve, kemi pranuar rolin e komisionit tonë në këtë proces dhe, pa dyshim, kemi pranuar, atë që do t’i ndante, “arbitrin ndërkombëtar”, që është Komisioni i Venecias, sipas të cilit të gjithë këta kanë bërë një punë të shkëlqyer. Kanë sjell një projekt me standarde europiane, me një strukturë të pranueshme, me themele të shëndosha. Mbetet që ju ta votoni, ta finalizoni përmes disa ndryshimeve, por me qëllim...

Në hyrje thuhet: “Projekti i ri merr parasysh pjesën më të madhe të kritikave të detajuara, që janë bërë më parë nga komisioni. Propozimet në formën aktuale përgjithësisht janë të arsyeshme. Ngelen disa probleme teknike, por që nuk duhet të jenë të pa zgjidhshme”, thuhet në pikën 8 të projektit të Komisionit të Venecias.

Po ashtu, dua të lexoj edhe pikën 11, që u lexua disa herë nga kolegët e mi, por që nuk u lexua e plotë. Se mirë që ne kemi lexime të ndryshme, por nuk bëjmë as lexime të plota.

Ne pikën 11 thuhet: “Gjithashtu, nga pikëpamja teorike është e vështirë të thuhet se cili nga këto institucione të reja nuk është i nevojshëm. Ka një argument të fortë për ekzistencën e të gjitha këtyre institucioneve. Në përfundim i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë sistemin e kontrolleve dhe të ekuilibrave. Një sistem i prekur gjerësisht nga korrupsioni mund të ketë më shumë nevojë për mekanizma kontrolli të jashtëm se sa një sistem më i shëndetshëm”. Për ta përmbledhur, thuhet: “Komisioni i Venecias është i përgatitur që ta konsiderojë të pranueshme strukturën institucionale të propozuar, ashtu siç është”. Pra, të gjithë këtë strukturë, të gjithë këtë ngrehinë të re kushtetuese është i përgatitur ta konsiderojë të pranueshme, siç është në projekt. Pra, të gjitha këto vlerësime dhe konkluzione tregojnë se kemi një projekt të punuar mirë, me përgjegjësi, me gjithëpërfshirje, me pjesëmarrjen e të gjithëve. Ky projekt ka disa çështje teknike dhe disa çështje politike, që duhen diskutuar dhe debatuar për ta çuar përpara. Pra, kemi një

projekt që do të thotë se ne sot kemi një gjë të jashtëzakonshme. Ne sot kemi një projekt kushtetues të vlerësuar dhe të certifikuar nga institucioni më prestigjioz në Europë e më gjerë, nga Komisioni i Venecias, i cili na ka thënë: “Ky projekt ka mbështetjen tonë, por ka edhe disa gjëra të hapura që ju duhet t’i diskutoni”. Çfarë janë gjërat e hapura? Ju thatë që ka një përpjekje infantile, për ta konsideruar se ka shumë çështje politike, por që ne duan ta fokusojnë te kjo, te kjo. Dakord, nuk na besoni ne?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, unë po i referohem, meqenëse ju shpeshherë u referoheni ndërkombëtarëve dhe mirë bëni, nuk ka asgjë të keqe, po i referohem një deklaratë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku thuhet: “Komisioni i Venecias në raportin përfundimtar ka ofruar udhëzime të qarta dhe kanë lënë vetëm një çështje qartësisht politike, atë të shumicës së cilësuar në duart e udhëheqësve politikë të Shqipërisë”.

Po ashtu, Ambasada e Shteteve të Bashkuara thekson: “Tani është koha që politikanët të ndërmarrin hapat e fundit drejt përfundimit të Reformës në Drejtësi. Ndryshimet e mëtejshme duhet t’i përmbahen raportit përfundimtar nga Komisioni i Venecias”. Pra, ata thonë dhe duhet ta respektojmë edhe mendimin e tyre, që kanë lënë vetëm një çështje qartësisht politike, atë të shumicës së cilësuar në duart e udhëheqësve politikë të Shqipërisë. Nuk besoj se kjo është një përpjekje tinëzare, për ta futur në rrugë pa fund, por e vërteta kjo është, në fakt. Kjo është çështja më e debatueshme.

Edhe ato nenet që lexuat ju, qoftë për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, qoftë për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, qoftë për zgjedhjen e komisionit të vlerësimit, qoftë për zgjedhjen e komisioneve të gjyqimit, nuk kanë të bëjnë me opinionin e Komisionit të Venecias, me arkitekturën: a do të jenë apo jo, por me mënyrën e formatimit të tyre. Në këtë pikë, unë jam dakord. Kjo është një çështje që kërkon një diskutim ndërmjet nesh. Absolutisht, jam dakord, por nuk mund të jem dakord që ju të thoni: “Komisioni i Venecias nuk e ka trajtuar Këshillin e Lartë të Emërimeve në Drejtësi, prandaj ne nuk jemi dakord”. Po thatë se nuk jeni dakord, atëherë nuk jeni dakord as me pikën 16, as me pikën 24 dhe as me pikën 40, ku këshilli i emërimeve në drejtësi pranohet, madje Komisioni i Venecias ka shkuar përtej projektit të ekspertëve dhe në pikën 40 ka thënë shprehimisht se, gjithashtu, nuk është e qartë se pse nuk kërkohet opinionin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për 3 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që zgjidhen nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative. Pra, jo thjesht që e pranon Këshillin e

Emërimeve në Drejtësi, jo thjesht që e quan të domosdoshëm, por e zgjeron rolin e tij në gjithë këtë proces, Komisioni i Venecias.

Doni të shkojmë më tutje? Për të gjitha çështjet që keni ngritur ju, ka kthyer përgjigje. A ka lënë një çështje? A ka lënë disa çështje? Po, çështja që lidhet me formatimin e institucioneve ka thënë se është një çështje sa ligjore aq dhe gjykimi politik. E kam thënë dhe herë tjetër, jam dakord me këtë gjë, ta diskutojmë atë që ju shpesh e quani kapje politike. Ju çfarë keni bërë? Ju fillimisht propozuat 2-3 projekte që kishte 3/5-at. Ju thatë 2/3-at dhe s'ka. Ju erdhi raporti i Komisionit të Venecias dhe ju tha se e keni lexuar gabim raportin. Nuk kemi dashur të themi këtë gjë ne. Nuk ka rëndësi, do ta shikojmë rrugës dhe këtë. Doni që ta bëni me 2/3-at, dakord. Doni ta bëni me 140 deputetë, ta diskutojmë. U tërhoqët dhe mirë bëtë, se ju dha një përgjigje Komisioni i Venecias, që nuk është me 2/3-at, ashtu siç e keni kuptuar ju, e keni kuptuar gabim, e keni të shkruar këtë gjë. Po, tha që ka zgjidhje, është me 3/5-at, por ka edhe zgjidhje të tjera. Dakord, ashtu e kanë gjykuar. Po, zgjidhje që kur janë me 3/5-at e ka kapur Edi Rama? Dhe zgjidhje kur 2 i propozoni ju dhe 3 i propozon PS-ja dhe LSI-ja, maxhoranca, nuk është kapje politike?

Kjo nuk është logjike e arsyeshme, sipas meje, kjo është personale. Unë kështu e gjykoj. Unë gjykoj që kur partitë politike përfshihen në këtë proces për ta futur politikën brenda në institucionet e drejtësisë është e gabuar. Por që partitë politike të përfshihen në procesin e zgjedhjes, absolutisht është e pranueshme dhe e drejtë. Hajdeni të gjejmë mënyrën, rrugën se si ta bëjmë. Dikush më tha se si do ta bëjmë këtë gjë?

Zotëri, ne sot bëme një dialog shumë të mirë politik dhe unë ju përgëzoj dhe ju vlerësoj për këtë gjë. Ju folët me orë të tëra, folët politikisht, dialoguam politikisht. Folët ju, folën kolegët këtej, kolegët në të majtën time, kolegët në të djathtën time. Pra, dëgjuam njëri-tjetrin, se unë nuk besoj që kolegët përballë jush ishin mur. Janë kolegë, siç jeni dhe ju. Ju dëgjuan me respekt, mbajtën shënime. Mund të mos jemi dakord me 10 nuk-et tuaja, por çfarë rëndësie ka, ju dëgjuam, ju na dëgjuat ne dhe po na dëgjoni që të kuptojmë se çfarë doni. Por që ju të sillni këtu 11 pika dhe të thoni që të gjitha këto duhet të bien, nuk jemi dakord, nuk ka sens. Kjo nuk shkon edhe me deklaratimet politike të udhëheqësve tuaj politikë, të cilët i kanë mbështetur dhe kanë thënë se i gjithë ky duhet të jetë një proces i fokusuar tek ekspertiza ndërkombëtare me certifikimin e Komisionit të Venecias.

Pra, ky ishte një dialog politik shumë i mirë dhe unë ju përgëzoj edhe ju, edhe kolegët e tjerë për këtë diskutim politik. Si bëhet ky procesi në parlament? Ne jemi parlamentarë, ne kemi një projekt dhe duhet të diskutojmë mbi atë projekt. Pa dyshim do ta marrim parasysh dhe relacionin kur diskutojmë projektet në komision, por ne marrim nene, ne marrim propozimet konkrete, si janë zgjidhjet konkrete dhe fillojmë të diskutojmë mbi nenet, natyrisht edhe mbi opinionet. Kjo është e domosdoshme për të ndërtuar një metodologji të shëndetshme, të qëndrueshme. A ka vend për dialog politik? Kush e ka përjashtuar parlamentin nga ky proces? Kush ka thënë që do të përjashtohet komisioni parlamentar nga ky proces? Absolutisht është marrëzi ta mendosh ndryshe. Por mund ta trajtosh si i marrë një gjë që nuk është. Absolutisht nuk e kemi thënë këtu në këtë komision, por do të diskutojmë mbi projektin dhe jo mbi deklarata politike. Ne i shfaqim qëndrimet politike, kemi një projekt, e ka parë dhe Komisioni i Venecias. Ka thënë që ka disa gjëra teknike. Këtë e themi ne, e thonë partnerët ndërkombëtarë, ka dhe 3-4 probleme që janë probleme politike. Partnerët thonë 1 problem, por mund të jenë dhe 2 dhe 3 probleme politike. Por për problemet politike të diskutojmë politikisht, për problemet teknike të diskutojmë teknikisht.

Ju do të më thoni mua se thatë për 11 çështje. Ju keni thënë aty që nuk duhet të ketë 2 prokurori paralele. Atëherë bie komplet filozofia që kemi ndërtuar bashkë me partnerët, përfshirë dhe byronë që thoni ju këtu, sepse ju keni konceptin që së paku nuk duhet të jetë një prokurori e specializuar, e pavarur. Pra, duhet të jetë absolutisht për autonomi të plotë, të shkëputur nga zyra e prokurorit të Përgjithshëm, kjo e thënë nga Komisioni i Venecias. Komisioni i Venecias e ka thënë këtë, jam plotësisht dakord.

Më ka pëlqyer sugjerimi i fundit që duhet të ketë një kontroll më të mirë mbi këtë strukturë. Po, jam dakord, ta diskutojmë. Kështu që çfarë duhet të bëjmë për këtë proces? Cili do të ishte një proces normal, një proces parlamentar? Një proces normal parlamentar, ju sugjeroj unë, në përmbyllje të të gjitha diskutimeve që u bënë këtu. Ne t'i marrim çështjet teknike, t'i diskutojmë me ekspertët teknikë, që do të thotë se zotërinjtë e nderuar që janë këtu, që përfaqësojnë dy misione asistence, dy organizata, Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ekspertët e tyre me 2 apo 3 ekspertë të nivelit të lartë që kanë punuar me këtë projekt, si dhe të nominojnë nga një ekspert të të gjitha grupeve politike parlamentare, apo 2 në rastin tuaj, që keni mbajtur një ngarkesë më të madhe në këtë proces, jam dakord. Mund ta keni këtë pretendim të arsyeshëm, të drejtë dhe ata të jenë pjesë e një tavoline pune ku të diskutojnë

projektin me sugjerimet teknike. Dhe ka të gjithë të drejtën, siç e ka PS-ja që të ketë një ekspert të vetin, që të shprehet aty për qëndrimet që ka PS-ja, të gjithë të drejtën e botës e ka dhe LSI-ja që ta ketë një të tillë. Ka të gjithë të drejtën e botës dhe PDIU-ja ta ketë një të tillë se ka një grup parlamentar, ashtu siç kanë të gjithë të drejtën e botës Partia Republikane që ka një grup parlamentar, pa dyshim edhe ju po e po si Parti Demokratike. Kjo në mënyrë që të mos marrim jo vetëm votat e PS-së dhe të PD-së, por të marrë 140 vota mundësisht në parlament që e mbështesin këtë projekt.

Pra, ekspertët e çdo grupi politik parlamentar të mblidhen bashkë me ekspertët që e kanë hartuar dhe që janë bashkëpronarë, se nuk mund t'ju themi që deri dje ju kishim bashkëortakë dhe bashkëpronarë, sot të ikni ju se e kemi ne. Po prisni, se e ndërtoam bashkë. T'ua lëmë mundësinë atyre të shprehen, të zgjidhin çështjet teknike. Besoj se duhet të keni besim tek ekspertët tuaj. Ata duhet t'ju thonë se 1, 2, 3, 4 janë çështje politike dhe ne nuk jemi të mandatuar për çështje politike, por do të duhet të zgjidhen politikisht. Dakord, mund ta bëjnë edhe këtë gjë. Dhe vjen diskutimi këtu në këtë sallë, apo jashtë kësaj salle, ulemi dhe bisedojmë, që ta përgatisim mbledhjen me shumë përgjegjësi midis nesh, i zgjidhim ato 3-4 çështje, apo nuk i zgjidhim. Mund të vijë me 1-2 variante alternative, i debatojmë me orë të tëra, me ditë të tëra derisa të kemi një produkt konsensual. Dhe kështu respektojmë dhe harmonizojmë punën e ekspertëve dhe shqyrtimin teknik të çështjeve që janë teknike edhe sipas Komisionit të Venecias me çështje që janë mirëfilli politike në vlerësimin e Komisionit të Venecias, apo dhe në vlerësimin tonë. Dhe kështu zhvillohet çdo procedurë normale parlamentare mbi një draft konkret. Bëjmë një diskutim në parim, e bëjmë 1 ditë, e bëjmë 2 ditë, e bëjmë 3 ditë, kjo është një çështje tjetër.

Pastaj pasi të kemi zgjidhur të gjitha çështjet teknike, vazhdojmë me çështjet që janë me kapituj po deshët, me nene po deshët, kjo është një çështje që e caktojmë ne. Kur nuk biem dakord, unë do t'ju propozoja sot atë që propozuan dhe disa nga kolegët këtu, themi se ju keni këtë mendim, ne kemi këtë mendim. A biem për ndonjë gjë dakord, se nuk do të mbarojmë kur ua lëmë dy projekteve, EURLIUS-it dhe OPDAT-it të na i ndajë në fund fare. Po, biem dakord me metodologjinë. Dhe kjo mund të jetë një metodologji e mençur që e zhbllokon ngërçin që mund të krijohet, dhe në fund fare mund të shkojmë te një draft konsensual.

Pra, hapat që duhet të hedhim janë që të ulen ekspertët nga një apo dy në rastin tuaj si Parti Demokratike me 3-4 ekspertë të nivelit të lartë që e kanë hartuar këtë, të biem dakord për

çështjet teknike, t'i mbyllin çështjet teknike dhe të vazhdojmë pastaj ne të diskutojmë çështjet politike. Bëjmë një diskutim për çështjet politike sipas atij parimit. Për çështjet që biem dakord i kalojmë shpejte shpejt, se biem dakord. Ndërsa për çështjet që nuk biem dakord i debatojmë. Kur ndahemi, ne u themi partnerëve, ekspertizës më të kualifikuar, që e kemi pranuar të gjithë, të na e ndajë në mënyrë që të kemi një zhbllokim. Kjo metodologji është një metodologji parlamentare, e shëndetshme, që na shërben të gjithëve. E ka brenda edhe ekspertizën, edhe dialogun politik. Pastaj nëse doni të diskutojmë këtu me orë të tëra me frazeologji politike, kushtetuese, ligjore, me lexime nga më të ndryshmet, me paragrafë të plotë apo me paragrafë të shkëputur, nuk do të bëjmë gjë tjetër veçse do të vijmë vërdallë me një gjë kaq të thjeshtë, kaq normale procedure parlamentare. Kështu që unë mendoj se pas këtij diskutimi arritëm të kuptojmë shumë mirë se cilat janë çështjet që preokupojnë njërin apo tjetrin grup politik, njërin apo tjetër koleg deputet, sepse ka dhe gjykime individuale, dhe tani ka ardhur momenti për të bërë hapin procedural, në mënyrë që të vijmë pastaj edhe te kjo tryezë edhe te ky debat për çështje politike që kërkojnë vendimmarrje politike?

Eduard Halimi – Pra, propozimi juaj është që sërish draftin e Venecias ta marrin ekspertët, të selektojnë ata se cilat janë çështjet politike, të zgjidhin çështjet e tyre ata, dhe të vijmë pastaj te ne dhe të trajtojmë çështjet politike.

Fatmir Xhafaj - Jo, e kuptuat gabim.

Eduard Halimi – Ndërkohë, propozimi ynë është tjetër. Ky propozim, them unë, nuk na çon gjëkund. Nuk na çon gjëkundi ky që t'ua lëmë përsëri ekspertëve qoftë tuajit, qoftë dhe ekspertëve tanë. Sa për pjesën e përbërjes pastaj, jam dakord, do ta diskutojmë dhe atë. Sigurisht duhet të jenë dhe ata të barabartë, dy nga ju, dy nga tanët, një LSI-ja, një PR-ja e me radhë. Domethënë për pjesën e ngritjes së grupit të ekspertëve që trajtojnë çështje teknike ne jemi dakord, sepse ka një numër të madh çështjesh që ngrihen nga Komisioni i Venecias në raportin e tij në ato 46 paragrafë që ne themi, që u sugjerojnë autoriteteve ta rishikojmë, që janë çështje teknike t'i diskutojnë ata. Jemi dakord, por ajo është faza e dytë.

Pse është faza e dytë? Faza ku jemi ne tani është faza ku duhet vendosim për çështjet politike dhe nuk duhet të presim. Pra, t'u thoni t'ia çojmë atyre, të rrinë nja 2 javë ata dhe të na thonë se cilat janë çështjet politike. Po ne i kemi çështjet politike këtu. Venecia, sipas qejfit të vet, a thua sikur nuk e shikojnë shqiptarët. Lexojmë këtu konkluzionet vetëm dy paragrafë. Çfarë thotë ai? Lexojmë vetëm falënderimet. Po pas falënderimeve ka sugjerime Komisioni i Venecias.

I sugjerojmë, thotë. Komisioni i Venecias u rekomandon autoriteteve shqiptare që t'u kushtojnë vëmendje çështjeve të mëposhtme. Këto janë çështjet. Dhe nëse duam që të ecim në proces, zgjidhja është e thjeshtë, të zbatohet vendimi i Komisionit të Venecias. Çfarë thotë? Venecia thotë se 7 herë për 7 çështje ka nevojë për dialog politik dhe i takon ligjvënësit të zgjidhë, të zgjidhim këto 7 çështjet. Dhe kishte, në mos gabo, një propozim racional, zoti Braho, kur tha që të bëhet një matricë me çështjet politike, të diskutohen. Çështjet teknike pastaj zgjidhen për 10 minuta. Dhe po themi jo të ecim pas një jave, as të presim 2 javë ekspertët që të na zgjidhin çështjet politike.

Unë them që nesër të vazhdojmë me çështjet politike se ne filluam sot të diskutojmë, por ne folëm këtë ju folët atë. Folëm 10 ne, ndërsa nga krahu juaj zero. Tani hapet një çështje për Këshillin e Emërimeve. Dakord ta diskutojmë këtë çështjen e Këshillit të Emërimeve. A biem dakord, nuk biem dakord, e skontojmë, nuk biem dakord. Unë kam argumentet, por nuk hapëm dialogun. Nuk kemi hapur dialogun politik ne.

Dëgjuat argumentet tona, ju thatë që të dhjetë janë për t'i rrëzuar. Unë po them hajde t'i diskutojmë këto 10 pika. Mund të gjejmë edhe ndonjë konsensus. Hapim dialogun politik nesër dhe t'i diskutojmë gjërat një më një. I mbyllim nesër, për 2 ditë, 10 ditë thotë zoti Braho, i mbyllim brenda javës. Vjen dhe raporti i Komisionit të Venecias. Javën tjetër mbyllim dialogun politik, nuk ngelet për 4 çështje, nuk i ndajmë ne, ndoshta i lexon Rama, ulet me Bashën dhe i ndajnë çështjet politike më lart, se nuk e ka lexuar draftin ai akoma, bashkë me Fatmirin, bashkë me të tjerët. Për çështjet që nuk biem dakord, ne duhet të hapim dialogun politik. Është hera e parë që ne po diskutojmë për draftin. Pra, propozimi që ta marrin ekspertët ta rishkruajnë dhe një herë nga e para dhe aty pastaj nuk do të gjejnë çështjet politike, të vijë prapë...

Ne e bëmë këtë eksperiment në janar dhe ja ku jemi 3 muaj me vonesë. E bëmë këtë eksperiment edhe me byronë. E kemi bërë për 2 vjet dhe kthehemi prapë pas 2 vjetësh dhe themi prit se këtë gjë do ta shkruajmë edhe një herë nga e para. Po të ishim ulur që atëherë bashkë do ta kishim zgjidhur para 2 vjetësh byronë. Ndaj propozimi që bëhet është që t'u jepet ekspertëve dhe pas 2 javësh ekspertët të vijë me propozimet që nuk i gjejnë ata, dhe ne pastaj të ulemi të gjejmë konsensusin politik, është rrugë boshe. Zgjidhim çështjet për 2-3 ditë. Pra, i zgjidhim çështjet me dialog politik, hapim dialogun politik, eliminojmë çështjet për të cilat nga ato 11 njëra mund të ketë rënë thotë zoti Mediu, njëra mund të ketë zgjidhje thotë zoti Braho. I zgjidhim çështjet dhe pastaj ecim.

Për Gjykatën e Lartë Administrative mund të gjendet konsensusi. Po sigurisht se është ndërtimi institucional. Mbajmë përgjegjësi për këto institucione që ngremë, se ne i ngremë kot. E kemi ne përgjegjësinë nuk e kanë ata. Ju thoni që e kanë ekspertët përgjegjësinë. Ne do të shkojmë përpara zgjedhësve. Unë kam shumë respekt dhe për partnerët dhe për organizatat partnere. Nuk dalin ata para qytetarëve, por do të dalim ne për zgjedhjet. Siç thotë me të drejtë, zoti Strazimiri, kemi ne përgjegjësi. Kam dhe unë përgjegjësitë e mia për atë kohë që kemi qeverisur. Ke dhe ti të tuat, ka dhe Pandi të vetat. Ne japim llogari, ne na vënë gishtin nëse e kemi bërë apo jo mirë. Nuk i thonë as Aurelës, as Gent Ibrahimit, as Enkelejd Alibeajt, as Gazit etj. Nuk janë ata përgjegjës politikë, jemi ne. Këto çështje duhet t'i zgjidhim ne. Nuk i zgjidhim, dakord, nuk i zgjidhim.

Ju thatë janë 11 pika, hajde të ulemi që të ngelemi në 2-3 pika. Pra, propozimi im është racional. Dhe me këtë propozim që thua ti është të vijmë prapë këtu dhe të vijmë pas 2 javësh ta bëjmë këtë diskutim që them unë. Unë them ta bëjmë nesër dhe jo pas 2 javësh. Pse i fshiheni dialogut ju? Ky që po bëjmë nuk është dialog. Dialogu është të fillojmë përmbajtjen e diskutimit ndoshta edhe pa praninë e medieve, se dhe emocionohemi dhe na kap patosi si juristë që jemi. I diskutojmë një më një të 11 çështjet që skontojmë edhe pa praninë e medieve. E kemi bërë këtë eksperiment me dekriminalizimin dhe ecim një më një me të gjitha pikat. E bëmë dhe atë eksperiment, se dhe me atë pikë donit të ecnit vetëm ju. Pra, unë po them të mos vonohemi një javë, por ta bëjmë nesër dialogun politik. Ju thoni të vazhdojnë ekspertët dhe hajde të flasim më vonë për dialogun politik. Kjo na kthen sigurisht në një proces që e vonon atë dhe nuk e bën atë më të shpejtë.

Fatmir Xhafaj – Unë mendoj se ajo çfarë diskutuam sot ishte një hap pozitiv përpara, ishte pozitive ajo që dija unë dhe shumë pak njerëz se çfarë mendonit ju për projektin. U bë publike dhe ju prezantuat që keni 11 pika. Doni komentin tim? Po. Në 11 pikat që keni ju vetëm 1 pikë është politike, formatimi i institucioneve. Asnjë pikë tjetër nuk është politike. Të gjitha të tjerat janë teknike.

Është mirë që të jemi të ndershëm kur flasim. Po, 7 herë. Janë për formatimin e KLGJ, që ju thoni se nuk duhet t'i ndërpritet mandati i KLD-së, por ja që e pranoni KLGJ-në. Është për formatimin e KLP-së, për zgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm, për kuorumin, për mënyrën po flasim të gjithë. Për çfarë forme? Për formulën. Dakord. Për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, për Komisionin e Vlerësimit, për Gjykatën e Apelit, komisione gjykimi. Pra, 6 janë institucionet

për të cilat flitet politikisht për formatimin, por është një çështje. Çfarë formule apo çfarë shumice do të përdoret? Është vetëm një, nuk ka të dytë. Çështjet e tjera të gjitha janë çështje teknike. A të zgjidhim këtë çështje, prandaj po ju them: të ulen ata, t'i shikojnë çështjet teknike, të caktoni zotin Alibeaj a ndonjë person tjetër, kë të caktoni ju, çështja juaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për një javë, dhe ne fillojmë menjëherë dialogun.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e kemi hapur dialogun. Ky që kemi bërë ishte dialog. Bëmë goxha dialog. Kemi tri orë që dialogojmë me njëri-tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para njëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bylykbashi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo që po ju themi ne është: ulemi e diskutojmë dhe nuk bëjmë dy xhiro. Bëjmë një diskutim këtu. Shkojmë tek ekspertët, thoni ju, e pastaj vimë prapë këtu. Jo. vetëm një herë atje e një herë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po filloi këtu, do të mbarojë këtu pastaj, s'ka më ekspertë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mbyllim, them unë. Reflektoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju apo zoti Mediu më përpara?

Zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Në fakt, unë nuk mendoj se konfliktojnë njëra-tjetrën. Secili nga ne merr një pozicion të caktuar dhe i qëndron pozicionit deri në fund.

Padyshim, ramë dakord që të ngrihet një grup ekspertësh. Dakord? Ata mund të shikojnë çështjet teknike. Juve vetë thatë se ka gjashtë probleme. Domethënë, për ju është çështje politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, është një çështje politike për gjashtë institucione. Atëherë, ne të mos e lëmë kohën bosh, por të vazhdojmë punën si komision, në raport me formatimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po s'ka rëndësi. Ata do merren, sepse nëse ne marrim një vendim, qoftë edhe koha e studimit të tyre për materialet e Komisionit të Venecias, është kohë e dobishme. Ndërkohë, ne s'kemi pse të rrimë e të presim.

Domethënë, është ajo çfarë po kërkon zoti Halimi. Ne po themi janë njëmbëdhjetë, ju thoni është një. Po ta fillojmë me atë një e shkojmë te njëmbëdhjeta. Se mbase arrijmë bindjen se janë të gjitha politike ato dhe kërkojnë një vullnet politik. Unë besoj se pa një vullnet politik, nuk ka asnjë zgjidhje teknike.

Në këtë pikëpamje, unë mendoj se duhet të formalizojmë patjetër diskutimin. E dini pse? Edhe për një arsye tjetër, zoti Xhafaj. Për pjesën tjetër, që ka thënë Komisioni i Venecias, draftin, është rënë dakord. Këto janë diferencat. Ne ta fillojmë këtu, ku kemi diferencat, për të arritur mirëkuptimin.

Mendoj se ky është niveli i dialogut politik, që duam të ndërtojmë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, nëse duam t'u hedhim hi syve edhe ekspertëve, edhe publikut, se ky është dialog politik, ose duhet të rivedinojmë çfarë është dialogu politik, ose pastaj, më mirë të mos tallemi me njëri-tjetrin, sepse shqiptarët e kuptojnë shumë mirë.

Unë uroj që, ai komisioni që filloi sot në mëngjes, në këtë sallë, të ulet përsëri, të ketë koncept krejt tjetër se çfarë është dialogu politik dhe kompromisi. Besoj se, duke ecur në traditën e tij të mëhershme, ka për të qenë ndryshe, ashtu siç do të ishte ky komision.

Tani, për t'ju thjeshtuar pak atë dilemën, unë besoj se prapë mbetet jo te infantiliteti, te versioni i kundërt, por meqë doni me se s'bën, meqë doni t'i bindni shqiptarët, po ua themi shqiptarëve se nuk është ashtu, që na qenka vetëm një çështje politike. Po ju themi zoti kryetar, e jua ka thënë edhe Komisioni i Venecias herën e parë, dhe në fakt nuk ka ndërruar mend: që është një sistem i rëndë, shumë i ngathët, me kompleksitet vendimmarrjesh dhe strukturash, që mund të çojnë në përkeqësimin e perceptimit mbi sistemin e drejtësisë. Është pikërisht ky sistemi, ku ju doni të aplikoni atë shumicën prej tre të pestash, që keni te sqetulla, që përkeqëson shumë edhe këtë çështje, një nga çështjet, pra çështjen e shumicës së cilësuar. Nëse do të kishit vetëm një nga

të gjithë anëtarët e sistemit të drejtësisë, që ju po kërkon të krijoni, të kishit vetëm njërin me shumicë të cilësuar, sigurisht që edhe mund t'jua falnim, t'ju thoshim: merreni dhe bëjeni me shumicë të thjeshtë, një person vetëm.

Nëse do të ishte vetëm Prokurori i Përgjithshëm, do të ishte shqetësim, sepse është në krye të një sistemi brenda sistemit të drejtësisë. Do të kishim debat, por dëmi do të ishte më i vogël. Por ju keni ngritur një sistem që është qëllimisht kështu, kompleks, me shumë institucione, ku dhe aplikoni shumicën tuaj të cilësuar, për të kapur sistemin e drejtësisë.

Prandaj ju themi: nuk është shumica problem, por janë të gjitha ato dhjetë problemet e tjera që unë listoj, nga kompleksiteti i sistemit. Nuk doni ta kuptoni? Nuk është se ju nuk e kuptoni, sepse objektivi është një dhe i vetëm. Juve të quani dialog këtë pozicionim tonin, dhe pastaj, me draftin tuaj nën shtetull, të thoni: do ta çojmë edhe një herë në Komisionin e Venecias.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ja, do t'ua çojmë edhe një herë ekspertëve. Unë po them, zoti kryetar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, diku u ngatërruat dhe shtegu ju çoi teposhtë. Mos e nisni edhe një herë atë shtegun, sepse prapë do të thyeni kokën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ristani – Zoti Xhafaj, ka një problem, siç e shoh unë. Komisioni i Venecias thotë se, përbërja pluraliste e KLGJ-së dhe KLP-së mund të arrihet dhe me mjete të tjera, jo domosdoshmërisht duke vendosur pragje të larta votimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Formula të tjera, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Tani, në rast se ne pranojmë se kemi edhe KLGJ edhe KLP. Do t'ua japim ekspertëve. Për KLGJ-në dhe për KLP-në, ekspertët do të na bien nga dy-tre variante, se si formatohet; ne do të zgjedhim një apo do të zgjedhin ata se si do të formatohet KLGJ-ja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit, pra! Këtu është problemi. Ne po themi se kjo është një gjë, të cilën mund ta zgjidhim ne, si na leverdis dhe si të biem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po formulat janë të gatshme. Një formulë e ke me prag, një formulë e ke me përfaqësim politik. Ta ka thënë më poshtë. Domethënë, duhet bërë ajo formulë, e cila siguron de facto përfaqësimin proporcional të forcave kryesore politike.

Tani ka dy gjëra. O biem ne dakord për formulën dhe i themi ekspertëve: “na e bëni me këtë formulë”, ose ata, për secilën nga këto, duhet të na vijmë me dy a tre formula, në mënyrë që ne, pastaj, të zgjedhim njëren. Apo jo? Po pra, kjo është. Duhet ta vendosim ne këtu, se në cilën rrugë do të ecim. Do t’u themi: na e sillni variantin me dy-tre formula, apo do t’u themi: kjo është formula që duam, që të na e kthejmë në dispozitë ligjore.

Edhe diçka tjetër: kur vjen puna te një kundërshti e jona, që kishim, ku ne nuk ishim dakord që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të futen nga jashtë sistemit. Sot e kemi Gjykatën e Lartë, që futet nga jashtë sistemit, apo jo? Ne mendojmë se Gjykata e Lartë duhet kthyer në gjykatë karriere. Po ky është diskutim politik. A ta kthejmë Gjykatën e Lartë në gjykatë karriere apo ta lëmë siç është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, të lutem. Ky është një diskutim që e bëjmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne themi që të mos futen në shkallë të parë gjyqtarë që s’kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Ky është diskutim që e vendosim ne. Ç’do të thotë ekspertit? Që të futen? Pse, eksperti do të vendosë që të futen nga jashtë magjistraturës apo jo? Është një gjë që duhet ta bisedojmë ne.

Si ta duash ti, ta bën ai. Me sistemin nga jashtë magjistraturës, ose në daç nga brenda. Do të shkruajë dispozitën eksperti. Nuk është eksperti që vendos se si e do ti: nëse e do Gjykatën e Lartë gjykatë karriere apo s’e do gjykatë karriere? Ky është diskutim politik, në të cilin vendosim ne.

Fatmir Xhafaj – Kam vetëm një pyetje për ju, vetëm një.

Arben Ristani – Po.

Fatmir Xhafaj – Ne, kur bëjmë diskutimin në komision, bëjmë diskutim mbi dispozita apo mbi hamendësime?

Arben Ristani – Ne, në komision, në atë të Ligjeve për shembull, bëjmë vërtetë diskutim mbi dispozita, por ama drejtimin e ka përcaktuar qeveria, e cila u ka thënë ekspertëve: ma bëni në këtë formë!

Fatmir Xhafaj – Po. Mbi një projekt, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk punojnë në mënyrë të pavarur ekspertët, për të prodhuar ligje. Nuk është se eksperti mendoj natën, prodhoi ligje dhe t'i sollti ty në komision. E ke porositur që ta bëjë, ta ka bërë, e pastaj ti e sheh nëse e ka bërë mirë apo jo. Por ama porosinë jemi ne që e japim, se si e duam sistemin: e duam me Gjykatën e lartë si gjykatë karriere, apo e duam siç e kemi? Çfarë reforme është, nëse e bëjmë siç e kemi? E duam me dy gjykata të larta apo e duam me gjykatë administrative, me dhomë administrative brenda Gjykatës së Lartë?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Arben Ristani – Ky është një diskutim që duhet ta bëjmë ne, se si është më mirë, çfarë të mirash ka njëri sistem, çfarë të mirash ka tjetri. Pse të mos i diskutojmë? Pastaj i japim detyrën ekspertit dhe i themi: bëje kështu ose bëje ashtu!

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë mendoj se diskutimi filloi me natyrë shumë të polarizuar, sepse opozita u shfaq me logjikën se çfarë do të bënte. Besoj që kam mirëkuptimin e kolegëve, se nga mesi i diskutimit filloi të kërkonte mekanizmat e konsensusit. Me dhjetë apo njëmbëdhjetë pika, që fillojnë me “nuk jemi dakord”, nuk hapet diskutim në asnjë lloj negociate. E para kjo.

E dyta, dua të më mirëkuptoni, jo se jam përballë medias, sepse tani është edhe ora kur dynjaja s'para e ka mendjen për të na parë ne, nuk jam shumë optimist se jemi duke ecur në rrugën e një konsensusi të madh politik.

Ku e kam fjalën? Kjo që po bëjmë është një reformë, e cila do të na hapë dyert e Bashkimit Europian. Duam apo s'duam ne, në një mënyrë të natyrës edhe politike, edhe jopolitike, kjo që po bëjmë, kjo që po diskutojmë, që quhet reformë e drejtësisë, është pjesë sa e vullnetit tonë, aq edhe një detyrim, për të trokitur në dyert e Bashkimit Europian, për atë nivel problematik që kemi në sistemin e drejtësisë dhe në sistemin e shtetit ligjor në Shqipëri.

Ndërkombëtarët na thonë: për t'u bërë apo për të filluar rrugëtimin e integritit, reforma në drejtësi është kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Ajo që kam si propozim, në mekanizëm, është se ne mund të bëjmë konsensus politik, por konsensus politik jashtë pronarëve, jashtë vullnetit të ekspertizës dhe bashkëpronarëve, që ne do të na ndjekin hap pas hapi, siç dhe na kanë ndjekur, unë mendoj se nuk mund të bëjmë.

Kështu, mendoj se kur ekspertët tanë, të majtë e të djathtë, janë të ndarë në pozicionet e tyre, ose të përafuar, por jo në njëqind për qind dakord, mendimi im është që të prevalojë propozimi apo pozicionimi i ekspertizës ndërkombëtare. E them këtë edhe për një arsye thjesht procedurale. Ne mund të bëjmë konsensus politik sa të duash, të këndojmë këngën e Gjylës nga mëngjesi e deri në darkë. Problemi është se e gjithë kjo mund të përfundojë në nul, në një reformë sa për të kaluar radhën, dhe nesër të vijë dikush e të na thotë: pritshmëritë e Brukselit, për shembull, për reformën e drejtësisë, nuk ishin ato që pritëshin, pasi në sistemin e drejtësisë vazhdon akoma i njëjti sistem i funksionimit të korrupsionit dhe i goditjes së ligjit e të sistemit legal.

Ky është problemi. Nëse konsensusin politik do ta shikojmë thjesht sa për të thënë se sa djem të mirë jemi, që merremi vesh me njëri-tjetrin, është kot. Prandaj thashë se nuk ecet me logjikën për t'i mësuar njëri-tjetrit se çfarë nuk duam. Prandaj, zoti kryetar, propozoj që nga mbledhja që vjen, të fillojmë diskutimin nen për nen. Sigurisht, duke kaluar te ekspertiza, sipas mekanizmit që sapo thashë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Strazimiri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Eduard Halimi – Tani, jemi duke diskutuar ndryshimet kushtetuese, Kushtetutën e vendit. Në ndryshimet kushtetuese, Kushtetuta e vendit është marrëveshje politike. Është kështu apo jo? S'mund të jetë ndryshe. Nuk është marrëveshje ekspertësh, por është marrëveshje politike, marrëveshje e palëve politike.

Ti që je një nga baballarët e Kushtetutës atëherë dhe e ke ndjekur, kryeministri e me radhë, të gjitha këto i di. Sa herë e ke ndryshuar Kushtetutën, kjo është bërë me marrëveshje. Nuk është bërë ndonjëherë vetëm. Gjithmonë është bërë me të dyja palët. Është kështu apo jo?

Çfarë kërkojmë ne? Çfarë themi ne? Ngremë njëmbëdhjetë çështje, të cilat i përkasin dialogut politik, por nuk janë çështje, për të cilat janë kundër partnerët ndërkombëtarë, sepse, për të gjitha këto, kur ne u ulëm bashkë dhe ramë dakord që të ishim bashkë në komision, në korrik, thamë se do të kemi si udhëheqës Komisionin e Venecias. Është kështu apo jo? U ulëm në zyrë,

së bashku me dy ambasadorët. Ramë dakord se do të kemi paritet dhe do t'u drejtohem Komisionit të Venecias.

Për ne, të njëmbëdhjetë çështjet janë çështje që adresohen këtu. Pra, zgjidhjet që ne propozojmë, apo që propozojmë për të dialoguar, dhe e thashë që në fillim se janë çështje për t'u dialoguar, e thashë që në fillim fare, zgjidhjet e këtyre çështjeve për të dialoguar bazohen te Komisioni i Venecias.

Pra, nuk kërkojmë zgjidhje, të cilat do të çudisin dynjanë. As ju nuk mund të bëni propozime që do të çudisnin dynjanë. Ishin disa propozime: heqja e të drejtës së apelimit a ku di unë. Ishin disa propozime që e çuditën Komisionin e Venecias. Nuk po u hy atyre. Nuk propozojmë ato. Propozojmë dialog për këto çështje, dhe kjo marrëveshje duhet të bëhet këtu. bëhet këtu, ngrihet në një nivel më të lartë. Është çështje e marrëveshjes politike, është çështje e dialogut politik.

Këtë nuk jua themi ne. Këtë jua thotë "Venecia". Thotë: janë të gjitha ato çështje, që lexoi, të gjashta a të shtata e me radhë, janë edhe çështje që kanë të bëjnë me...Thotë: "U kërkojmë autoriteteve shqiptare se projektndryshimet duhet të specifikojnë metodën e emërimit të kryeprokurorit të posaçëm dhe mekanizmat e llogaridhënies nga ana e tij, e saj".

Kjo është. Nuk është prokurori paralele. Po kërkon këtë. Propozoni ju. E kanë politike, nuk e kanë me ekspertët. Më fal ë? Po ata që janë andej, janë ekspertë më të mirë se këta që kemi neve, të PD-së e të PS-së bashkë. Biem dakord apo jo? Ata ekspertë atje, të Komisionit të Venecias, i kanë shoshitur dhe kanë thënë: ore, këtë çështjen e emërimit, përveç këtyre, duhet ta bëni ju, me zgjidhje politike. Edhe çështjen e arkitekturës e keni ju, si zgjidhje politike. Ju vendoseni, thotë.

Mandati i organeve vlerësuese duhet të shkurtohet ndjeshëm. Duhet ta bëjmë politike, se po të jetë për ekspertë, ata janë më të mirë se ne. Dhe thoshin jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kenë të drejtë të ankimojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e zgjidhin ata. E zgjidhim ne. E vendosim ne. Po pse, kush do të vendosë? Do të vendosin ekspertët atë që duhet të pranojmë ne, që në Gjykatën e Lartë të mos venë nga Shkolla e Magjistraturës apo jo? Duhet të venë vetëm nga Shkolla e magjistraturës në sistemin gjyqësor? Po është vendim politik. E kemi bërë këtë debat. Ne do ta bëjmë prapë këtu. Po pse, Gjykatën e

Lartë gjykatë karriere do ta caktojnë ekspertët? Jo. Prandaj dhe diskutimi ynë dhe oferta jonë është për të ecur më shpejt. Hajt t'i mbyllim këto brenda dy ditëve, e pastaj ekspertët aty janë. Ju thoni: tua çojmë ekspertëve, të rrinë ekspertët e të na i sjellin neve mbrapsht pastaj. Jo, jo, çështja është të ecim sa më shpejt dhe, brenda dy ditëve, tri ditëve, ta zgjidhim këtë. Ky është propozimi ynë. Kjo e bën më të shpejtë procesin.

Fatmir Xhafaj – Jua thashë edhe qëparë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, s'ka problem. Të lutem.

Unë thjesht moderoj, nuk kam status të veçantë, kështu që di ta respektoj vendin tim dhe tuajin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gent Strazimiri – Kam përshtypjen se po shkojmë atje ku tha zoti Majko. Zoti Majko ngriti një pyetje, të cilën nuk e bëri në fillim, në fakt. Tha; ta zëmë se kjo punë nuk vete ashtu siç duhet; çfarë do t'i themi Europës?

Ç'do t'i thuash, o Pandi? Atë që thashë unë? E kanë bërë ekspertët? Dështoi pak gjëja, por e kanë bërë ekspertët. S'e kemi bërë neve. Në qoftë se do t'i biesh derës te Europa, do t'i biem ti dhe unë, politikisht, me përgjegjësi politike, dhe nesër, pasnesër, edhe po të duam, nuk fshihemi dot pas ekspertëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, si do t'ia bëjmë tani? Është hera e parë që biem në këto kushte? Nuk është hera e parë. Jua përmendi kolegu Halimi: marrëveshje politike ne kemi bërë disa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti moderator, të lutem, më lërë të mbaroj! Mos më ndërhyj!

Kemi bërë disa marrëveshje politike, dhe jo pa rezultat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si i kemi bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në daçi zgjidheni modelin e marrëveshjes politike, kur u bë ligji elektoral në vitin 2009, në daçi ndryshimet në Kushtetutë, në vitin 2008! Çfarë doni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj, që po përmendet shumë sot, edhe këtë ta ka dhënë: metodologjinë. Ta ka dhënë. Kur lexoni deklaratat e të gjithë personaliteteve të respektuara, që i nxirni jashtë kontekstit, mirë është të përdorni një deklaratë. Të cilën jua tha këtu, në mes të Tiranës, Komisioni i Venecias. Ju tha: keni një eksperiencë shumë të mirë për t'u marrë vesh mbi diskordancat politike. Sapo keni arritur me sukses të bëni ligjin e dekriminalizimit.

Si e bëmë ligjin e dekriminalizimit ne? E çuam një herë te ekspertët, e pastaj thamë: prit, se nuk e dimë, se do ta sjellin ekspertët, do ta çojmë te "Venecia", pastaj e marrin prapë ekspertët dhe e shohin? Jo. Nuk ka qenë kështu. Unë s'e marr vesh se përse ju e harroni gjithmonë këtë eksperiencë kaq të suksesshme. Në fakt, ti përmende deklaratën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të ambasadës së saj, ndërkohë që i vetmi sukses që të njohu Sekretari Kerri, kur ishte këtu, në një vizitë historike, ishte dekriminalizimi.

Në qoftë se do sukses për këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sigurisht. Sigurisht, tha atë që kemi thënë të gjithë, e që e themi akoma sot e kësaj dite. Problemi është se ne mbytemi te metodologjia. Metodologjinë, Pandi ka frikë ta prekë me dorë. Thotë se e bëjnë ekspertët, nuk e bëjmë ne.

Në fakt, në fakt, dekriminalizimin, të vetmi sukses që kemi pasur, nuk e kanë bërë ekspertët, por e kemi bërë ne. Ka qenë vetëm konsensus e asgjë tjetër. Se përse duhet tani, që ta nisim rrotën e t'i biem rreth e qark, rreth e qark e rreth e qark, kur, siç thoni ju, kemi urgjencë, se po na pret Europa që t'i biem derës, dhe po s'vajtëm me këtë gjë në dorë, nuk na e hap derën, atëherë, o burra, le të marrim shembullin më të mirë të bashkëpunimit, nuk e refuzojmë bashkëpunimin. Marrim shembullin më të mirë të suksesit, nuk refuzojmë shembullin që na ka sjellë suksesin. Është metodologji. Ta ka thënë edhe Komisioni i Venecias, si metodologji. Brenda pikave që ajo ka thënë, të ka dhënë edhe udhërrëfyesin: "ju e keni eksperiencën për të arritur në këtë sukses". Sapo e kryem.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Besoj se, pak a shumë, gjërat u qartësuan. Do t'ju lëmë kohën e nevojshme. Sot ishte një diskutim i frytshëm. Le të reflektoni për të gjitha, por mos harroni asnjëherë: ky është proces parlamentar dhe ne jemi komision parlamentar, që veprojmë mbi bazën e Kushtetutës e të Rregullores parlamentare.

Faleminderit!

Natën e mirë!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë